

LETRA ENCIKLIKE
LUMEN FIDEI

E ATIT TË SHENJTË
FRANÇESKU

*DREJTUAR IPESHKVIJVE,
PRESBITERËVE DHE DIAKONËVE,
PERSONAVE TË KUSHTUAR
DHE TË GJITHË BESIMTARËVE LAIKË
MBI FENË*

**Nën kujdesin
e Arqipeshkvisë Shkodër - Pult
Shtator 2013**

*Përktheu nga italishtja
Angjelina Gjeka*

*Redaktorë
Loreta Tomaj
Teola Shkodra*

© Copyright: www.vatican.va

© Copyright në shqip
ARQIPESHK VIA METROPOLITANE
SHKODËR - PULT

Paraqitja

Me gëzim të madh ju paraqes letrën e parë enciklike të Papës Françesku, “Lumen Fidei”, në gjuhën shqipe, një enciklikë “me katër duar”, siç e ka përkufizuar me shaka vetë Papa. Enciklika ka katër kapituj, përveç parathënies, të firmosur nga Papa Françesku më 29 qershor, 2013, e krentja e Shenjtërve Pjetër e Pal. Në tekst Papa Françesku sqaron se kjo enciklikë i shtohet: “Asaj që Benedikti XVI ka shkruar në Letrat enciklike mbi dashurinë dhe mbi shpresën”. “Ai – vazhdon – pothuajse e kishte plotësuar një hartim të parë të Letrës

Enciklike mbi fenë. I jam thëllësisht mirënjohës për këtë dhe, në vëllazërinë e Krishtit, marr punën e tij të çmueshme, duke i shtuar tekstit disa ndihmesa të mëtejshme”.

“Në enciklikë – ka vënë në dukje kardinali Marc Ouellet, prefekt i Kongregatës së Ipeshkvinjve, duke paraqitur dokumentin – ka shumë nga Benedikti XVI dhe ka gjithçka nga Françesku, sepse e ka marrë tekstin në rolin e tij si dëshmitar i fesë”.

“Lumen Fidei”, është ndërtuar mbi forcën e binomit: dritë dhe dashuri. Drita është dhurata e madhe e sjellë nga Jezusi që në ungjillin e Gjonit paraqitet: “Unë – drita – erdha në botë, që, kushdo që beson në mua, të mos mbetet në terr” (Gjn 12,46). Papa thotë: “Kush beson, sheh, sheh me një dritë që ndriçon krejt itinerarin e rrugës, sepse na vjen prej Krishtit të rin-gjallur, yllit të mëngjesit që nuk perëndon”. Kjo shprehje dhe shumë të tjera në Enciklikë, edhe pse nuk kanë përmbajtje të reja, kanë një forcë të madhe ndikuese dhe ngrohin zemrën.

“Drita e fesë – me këtë shprehje e ka treguar tradita e Kishës dhuratën e madhe të sjellë prej Jezusit”. “Kur mungon drita – vazhdon Papa – gjithçka bëhet e pështjelluar, është e pamundur të dallohet e mira prej së keqes”.

Kapitulli i parë na paraqet Abrahamin, Atin tonë në fe. Feja është e lidhur me dëgjimin. Abrahami nuk e sheh Hyjin por dëgjon zërin e tij. Feja “sheh në masën në të cilën ecën, në të cilën hyn në hapësirën e hapur të Fjalës së Hyjit. Feja, pra, shpjegohet duke pasur parasysh fillimisht “dëgjimin”, pastaj “thirrjen” për të dalë prej vetvetes, “premtimin” (“pasardhësia jote – citon Zanafilla – do të jetë e madhe, do të jesh ati i një populli të madh”) “drejt një të ardhmeje të papritur”. Feja e Abrahamit do të jetë gjithmonë një akt kujtese por jo një kujtesë e fiksuar në të kaluarën, por me aftësi që t’i hapet së ardhmes, të ndriçojë hapat përgjatë rrugës, pra është e lidhur ngushtë me shpresën. Abrahamit i kërkohet t’i zërë besë Fjalës së Hyjit. “Feja e pranon këtë Fjalë si shkëmbin e sigurt mbi të cilin mund të ndërtohet me themele të qëndrueshme”.

Papa Françesku ndalet gjatë në konceptin e idhujtarisë. “Në vend të fesë në Hyjin parapëlqehet të adhurohet idhulli, fytyra e të cilit mund të shikohet, zanafilla e të cilit është e njohur sepse është bërë prej nesh”. Për Papën, “idhulli është një pretekst për ta vënë vetveten në qendrën e realitetit, në adhurimin e veprës së duarve tona”. Por feja “është e kundërta e idhujtarisë, është ndarje prej idhujve për t’u kthyer te Hyji i gjallë, nëpërmjet një takimi personal. Të besosh do të thotë t’i besohesh një dashurie të mëshirshme që gjithmonë pranon e fal, që mbështet dhe orienton ekzistencën”.

Në kapitullin e dytë, Papa flet për marrë-dhënien mes fesë e së vërtetës dhe dënon çdo formë të totalitarizmit. “Feja, pa të vërtetën, nuk shpëton” dhe “mbetet një përrallë e bukur”. “Të kujtojmë lidhjen e fesë me të vërtetën sot është më e nevojshme se kurrë, pikërisht prej krizës së të vërtetës në të cilën jetojmë”. “Në kulturën bashkëkohore njerëzit shpesh janë të prirur ta pranojnë si të vërtetë vetëm atë të teknologjisë” dhe “e vërteta e madhe shikohet me dyshim. A nuk ka qenë kjo – pyesim veten – e vërteta e pretenduar prej totalitarizmave të mëdhenj të shekullit të kaluar, një e vërtetë që impononte konceptimin e vet global për ta shtypur historinë konkrete të individit?”.

Theksohet se “Nëse dashuria ka nevojë për të vërtetën, edhe e vërteta ka nevojë për dashurinë. Dashuria dhe e vërteta nuk mund të ndahen. “Pa dashurinë, e vërteta bëhet e ftohtë, jo personale, shtypëse për jetën konkrete të personit. E vërteta që kërkohet, ajo që u jep domethënie hapave tanë, na ndriçon kur jemi të prekur prej dashurisë”.

Kapitulli i tretë ndalet në sakramentet. “Është e pamundur të besojmë vetëm... Ajo (feja) për natyrë të vet, i hapet “ne”-së... Ai që merr fenë zbulon se hapësirat e “unit” të tij zgjerohen, dhe në të lindin marrëdhënie të reja që e pasurojnë jetën”. Papa na kujton se “feja ka nevojë për një fushë në të cilën të mund të dëshmohet e komunikohet”. Dhe përsëri, “ajo që komunikohet në Kishë, ajo që përçohet në Traditën e saj të gjallë, është drita e re që lind prej takimit me Hyjin e gjallë, një dritë që e prek personin në qendrën e tij, në zemër, duke

përfshirë mendjen e tij, vullnetin e tij dhe afektivitetin e tij, duke ua hapur marrëdhëniet të gjalla në bashkim me Hyjin dhe me të tjerët. Për ta përçarur këtë plotësi ekziston një mjet i veçantë, që vë në lojë gjithë personin, trup e shpirt, brendësi dhe marrëdhënie. Ky mjet janë Sakramentet, të kremtuara në liturgjinë e Kishës. Në ta komunikohet një kujtesë e mishëruar”. Ky përçim i fesë ndodh në radhë të parë në pagëzim dhe arrin shprehjen e vet më të lartë në Eukaristinë.

Në kapitullin e katërt Papa thotë se “të premtojmë një dashuri të përhershme është e mundur kur zbulojmë një plan më të madh se planet tona, që na mbështet dhe na lejon t’i dhurojmë krejt të ardhmen personit të dashur”, dhe përsëri, “Mjedisi i parë në të cilin feja ndriçon qytetin e njerëzve gjendet në familjen, ‘bashkimi i qëndrueshëm i burrit dhe i gruas në martesë’”. Papa Françesku flet për “njohjen dhe pranimin e mirësisë së ndryshimit gjinor, gjë prej së cilës bashkëshortët mund të bashkohen në një trup të vetëm dhe janë të aftë të lindin një jetë të re”. Dashuria e bashkëshortëve, shkruan Papa, “përfshin gjithë jetën dhe kujton shumë karakteristika të fesë”.

Dhe ja zemra e Letrës: dëshmimi i fesë në shoqëri, në çdo fushë, “pa u turpëruar”. “Një e vërtetë e përbashkët na shtie frikën – thotë papa - sepse e identifikojmë me imponimin e ngurtë të totalitarizmave”. Por “nëse e vërteta është e vërtetë e dashurisë, nëse është e vërteta që hapet në takimin personal me Tjetrin dhe me të tjerët, atëherë mbetet e liruar prej mbylljes së individit dhe mund të bëjë pjesë në të mirën e përbashkët” dhe sidomos “nuk imponohet me dhunë” dhe prandaj “nuk është e vërtetë që e shtyp individin”. “Në bashkimin me fenë dhe dashurinë – përfundon Papa – shpresa na projekton drejt së ardhmes së sigurt, që vendoset në një perspektivë të ndryshme në krahasim me propozimet mashtruese të idhujve të botës, por që i dhuron një hov të ri dhe një forcë të re jetës së përditshme”. Papa bën një thirrje të fortë duke thënë: “Të mos lejojmë që të na vidhet shpresa, të mos lejojmë që ajo të asgjësohet me zgjidhje dhe propozime të menjëhershme që na bllokojnë në ecje”.

Paragrafi i fundit i kushtohet Marisë, së cilës Papa i drejtohet në lutje, duke i besuar punën e vet të parë.

Le ta presim pra, të dashur vëllezër, këtë dhuratë të madhe dhe të çmueshme që na është dhënë, që na jep mundësinë që, nëpërmjet le-ximit dhe meditimit të saj, jeta jonë shpirtërore të rinohet, të mbushet me ngrohtësi, me entuziazëm, me një dëshirë të zjarrtë për të jetuar një jetë gjithnjë e më të plotë në Jezu Krishtin, dhe për t’u shndërruar në dëshmitarë e apostuj të njëmendtë të vdekjes dhe ngjalljes së tij.

† **Angelo Massafra OFM**

Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult

President i Konferencës Ipeshkvnore

të Shqipërisë

1. DRITA E FESË: me këtë shprehje, tradita e Kishës ka treguar dhuratën e madhe të sjellë nga Jezusi, i cili, në Ungjillin e Gjonit, paraqitet kështu: «Unë - drita - erdha në botë, që, kushdo që beson në mua, të mos mbetet në terr» (Gjn 12,46). Edhe shën Pali shprehet në këto terma: «Hyji që tha: “Prej errësirës le të shndrisë drita”, ai ndriti në zemrat tona» (2 Kor 4,6). Në botën pagane, të uritur për dritë, ishte zhvilluar kulti ndaj hyjnisë Diell, Sol invictus, të cilit i drejtoheshin me lutje në momentin e lindjes së tij. Edhe pse dielli rilindte çdo ditë, kuptohej mirë se ishte i paaftë ta rrezatonte dritën e vet mbi krejt ekzistencën e njeriut. Në të vërtetë, dielli nuk ndriçon krejt realen, rrezja e tij është e paaftë të arrijë deri në hijen e vdekjes, aty ku syri njerëzor mbyllet para dritës së tij. «Për besimin e vet në Diell - pohon shën Justini Martir - askush nuk ka qenë i gatshëm të vdesë».¹ Të vetëdijshëm për

¹1. *Dialogus cum Tryphone Iudaeo*, 121, 2: PG 6, 758.

horizontin e madh që feja u hapte atyre, të krishterët e quajten Krishtin diellin e vërtetë, «rrezet e të cilit dhurojnë jetën».² Martës, që qan për vdekjen e vëllait të saj Lazrit, Jezusi i thotë: «A nuk të thashë nëse do të besosh, do ta shohësh lavdinë e Hyjit?» (Gjn 11,40). Ai që beson, sheh; sheh me një dritë që ndriçon krejt rrugën, sepse na vjen prej Krishtit të ngjallur, yllit të mëngjesit që nuk perëndon.

Një dritë e rreme?

2. Megjithatë, duke folur për këtë dritë të fesë, mund të dëgjojmë kundërshtimin e shumë bashkëkohësve tanë. Në epokën moderne është menduar se një dritë e tillë mund të mjaftonte për shoqëritë e lashta, por nuk shërbente për kohët e reja, për njeriun që ishte rritur, krenar për arsyen e vet, plot me dëshirën që ta eksplorojë në mënyrë të re të ardhmen. Në këtë kuptim, feja dukej si një dritë e rreme, që e pengonte njeriun të kultivonte guximin e dijes. Niçja i ri e ftonte motrën e vet Elizabetë që të rrezikonte, duke përshkuar «rrugë të reja..., në pasigurinë e të ecurit autonom». Shtonte: «Në këtë pikë ndahen udhët e njerëzimit: nëse dëshiron të arrish paqen e shpirtit dhe lumturinë, ki fe, por nëse dëshiron të jesh një nxënës i së vërtetës, atëherë hulumto».³ Në këtë mënyrë të besuarit do t'i kundërvihet të kërkuarit. Duke u nisur prej këtu, Niçja do të zhvillojë kritikën e vet ndaj krishterimit për faktin se ka zvogëluar rëndësinë e ekzistencës njerëzore, duke i hequr jetës risinë dhe aventurën. Kështu feja do të ishte si një iluzion drite, që e pengon ecjen tonë si njerëz të lirë drejt së nesërme.

3. Në këtë proces, feja ka përfunduar të lidhet me errësirën. Është menduar se mund të ruhet, se mund të gjendet për të një hapësirë në mënyrë që të bashkëjetonte me dritën e arsyes. Hapësira për fenë hapej aty ku arsyeja nuk mund të ndriçonte, aty ku njeriu nuk mund të kishte më siguri. Atëherë feja është kuptuar si një kërcim në zbrazëtirë që e bëjmë prej mungesës së dritës, të shtyrë nga një ndjenjë e verbër; ose si një dritë subjektive, e aftë ndoshta të ngrohë zemrën, të sjellë një ngushëllim privat, por që nuk mund t'u propozohet të tjerëve si dritë objektive dhe e përbashkët për të ndriçuar ecjen. Por, pak nga pak, është parë se drita e arsyes autonome nuk arrin ta ndriçojë aq sa duhet të ardhmen; në fund, ajo mbetet në errësirën e vet dhe e lë njeriun në frikën e të panjohurës. Kështu njeriu ka hequr dorë prej kërkimit të një drite të madhe, të një të vërtete të madhe, për t'u kënaqur me dritat e vogla që ndriçojnë çastin e shkurtër, por që janë të paafta të hapin rrugën. Kur mungon drita, gjithçka bëhet e turbullt, është e pamundur të dallohet e mira prej së keqes, është e pamundur të dallohet rruga që të çon te caku prej asaj që na bën të ecim në rrathë monotone, pa drejtim.

Një dritë që duhet rizbuluar

4. Prandaj është e ngutshme të rifitohet karakteri i dritës që i përket fesë, sepse kur flaka e saj shuhet edhe të gjitha dritat e tjera e humbin fuqinë e tyre. Në të vërtetë, drita e fesë ka një karakter të

². KLEMENTI I ALEKSANDRISË, *Protrepticus*, IX: PG 8, 195.

³. *Brief an Elisabeth Nietzsche* (11 qershor 1865), te: *Werke in drei Bänden*, Mynih 1954, 953 e vijim.

posaçëm, duke qenë e aftë të ndriçojë krejt ekzistencën e njeriut. Që një dritë të jetë kaq e fuqishme, nuk mund të dalë prej vetes sonë, duhet të vijë nga një burim më i drejtpërdrejtë, duhet të vijë, në fund të fundit, nga Hyji. Feja lind në takimin me Hyjin e gjallë, që na thërret dhe na zbulon dashurinë e vet, një dashuri që na paraprin dhe në të cilën mund të mbështetemi për të qenë të qëndrueshëm dhe për të ndërtuar jetën. Të shndërruar prej kësaj dashurie marrim sy të rinj, përjetojmë se në të gjendet një premtim i madh i plotësisë dhe na hapet shikimi i të ardhmes. Feja, që e marrim nga Hyji si dhuratë mbinatyrore, shfaqet si dritë për rrugën, dritë që orienton ecjen tonë në kohë. Nga njëra anë, ajo vjen prej së kaluarës, është drita e një kujtimi themelues, ajo e jetës së Jezusit, ku është shfaqur dashuria e tij plotësisht e besueshme, e aftë ta mposhtë vdekjen. Por, në të njëjtën kohë, meqenëse Krishti është ngjallur dhe na tërheq përtej vdekjes, feja është dritë që vjen prej së ardhmes, që hap para nesh horizonte të mëdha, dhe na çon përtej “un”-it tonë të izoluar drejt gjerësisë së bashkësisë. Kështu kuptojmë se feja nuk banon në errësirë; se ajo është një dritë për errësirat tona. Dante, në veprën e tij “Komedia Hyjnore”, pasi dëshmon fenë e vet përpara shën Pjetrit, e përshkruan atë si një “shkëndijë, / që përhapet pastaj në flakë të gjallë / dhe si yll në qiell në mua shndrit”.⁴ Pikërisht për këtë dritë të fesë do të doja të flisja, që të rritet për të ndriçuar të tashmen derisa të bëhet yll që tregon horizontet e ecjes sonë, në një kohë në të cilën njeriu ka veçanërisht nevojë për dritë.

5. Zoti Jezus, përpara mundimeve të veta, e siguronte Pjetrin: «Unë u luta për ty, që feja jote të mos mungojë» (Lk 22,32). Pastaj i ka kërkuar “t’i forcojë vëllezërit” në po këtë fe. I vetëdijshëm për detyrën besuar Pasardhësit të Pjetrit, Benedikti XVI ka dashur ta shpallë këtë Vit të fesë, një kohë hiri që është duke na ndihmuar të ndiejmë gëzimin e madh të të besuarit, të gjallërojmë perceptimin e gjerësisë së horizonteve që feja hap, për ta dëshmuar atë në njësinë dhe tërësinë e saj, besnikë ndaj kujtimit të Zotit Jezus, të mbështetur prej pranisë së tij dhe prej veprimit të Shpirtit Shenjt. Bindja e një feje që e bën jetën të madhe dhe të plotë, të përqendruar në Krishtin dhe në forcën e hirit të tij, frymëzonte misionin e të krishterëve të parë. Në Veprat e martirëve lexojmë këtë dialog mes prefektit romak Rustik dhe të krishterit Gjerac: «Ku janë prindërit e tu?», e pyeti gjykatësi martirin, dhe ky u përgjigj: «Ati ynë i vërtetë është Krishti, dhe nëna jonë feja në Të».⁵ Për ata të krishterë feja, si takim me Hyjin e gjallë të dëftuar në Krishtin, ishte një “nënë”, sepse i bënte të dilnin në dritë, lindte në ta jetën hyjnore, një përvojë të re, një shikim të ndritshëm të ekzistencës, prandaj ishin të gatshëm të jepnin dëshmi publike deri në fund.

6. Viti i fesë ka filluar me rastin e 50-vjetorit të hapjes së Koncilit II të Vatikanit. Kjo njëkohësi na lejon të shohim se Vatikani II ka qenë një Koncil mbi fenë,⁶ sepse na ka ftuar të rivendosim në qendrën e jetës sonë kishtarë dhe personale parësinë e Hyjit në Krishtin. Në të vërtetë, Kisha nuk e

⁴ Parajsa XXIV, 145-147.

⁵ *Acta Sanctorum*, Iunii, I, 21.

⁶ “Edhe pse Koncili nuk bën fjalë shprehimisht për fenë, flet për të në çdo faqe, njeh karakterin e saj jetësor dhe mbinatyror, e supozon të tërësishme e të fortë dhe ndërton mbi të mësimet e veta. Mjafton të kujtojmë pohimet konciliare [...] për të kuptuar rëndësinë thelbësore që Koncili, koherent me traditën doktrinale të Kishës, i jep fesë, fesë së vërtetë, asaj që ka si burim Krishtin dhe si shtrat magjisterin e Kishës” (Pali VI, *Audienca e përgjigjive të shprehura*, [8 mars 1967] : *Mësimet* V [1967], 705).

presupozon kurrë fenë si një fakt të sigurt, por e di se kjo dhuratë e Hyjit duhet të ushqehet dhe të forcohet, që të vazhdojë ta udhëheqë ecjen e saj. Koncili II i Vatikanit ka bërë që feja të shkëlqejë brenda përvojës njerëzore, duke përshkuar kështu rrugët e njeriut bashkëkohor. Në këtë mënyrë është shfaqur se si feja e pasuron ekzistencën njerëzore në të gjitha përmasat e saj.

7. Këto vlerësime mbi fenë - në vazhdimësi me gjithçka që Magjisteri i Kishës ka shpallur në lidhje me këtë virtyt teologal⁷ -, kanë për qëllim t'i shtohen asaj që Benedikti XVI ka shkruar në Letrat enciklike mbi dashurinë dhe mbi shpresën. Ai gati pothuajse i kishte dhënë dorën e parë një Letre enciklike mbi fenë. I jam thëllësisht mirënjohës për këtë gjë dhe, në vëllazërinë e Krishtit, marr punën e tij të çmueshme, duke i shtuar tekstit disa pjesë të tjera. Pasardhësi i Pjetrit, dje, sot e nesër, në të vërtetë është gjithmonë i thirrur "t'i forcojë vëllezërit" në atë thesar të pamasë të fesë që Hyji e dhuron si dritë në rrugën e çdo njeriu.

Në fe, dhuratë e Hyjit, virtyt mbinatyror i komunikuar prej Tij, pranojmë se një Dashuri e madhe na është dhënë, se një Fjalë e mirë na është drejtuar dhe se, duke e pranuar këtë Fjalë, që është Jezu Krishti, Fjala e mishëruar, Shpirti Shenjt na shndërron, na e ndriçon rrugën e së ardhmes dhe bën që të rriten në ne krahët e shpresës për ta përshkuar atë me gëzim. Feja, shpresa dhe dashuria përbëjnë, në një gërshetim të mrekullueshëm, dinamizmin e ekzistencës së krishterë drejt bashkësisë të plotë me Hyjin. Si është kjo udhë që feja hap para nesh? Prej nga vjen drita e saj e fuqishme, që lejon të ndriçohet ecja e një jete të arrirë dhe të frytshme, plot me fryt?

KAPITULLI I PARË

I BESUAM DASHURISË

(krh. 1 Gjn 4,16)

Abrahami, ati ynë në fe

8. Feja na e hap rrugën dhe i shoqëron hapat tanë në histori. Pikërisht për këtë arsye, nëse duam të kuptojmë se çfarë është feja, duhet të tregojmë rrugëtimin e saj, udhën e njerëzve besimtarë, të dëshmuar në radhë të parë në Besëlidhjen e Vjetër. Një vend i veçantë i përket Abrahamit, atit tonë në fe. Në jetën e tij ndodh një fakt tronditës: Hyji i drejton Fjalën, zbulohet si një Hyj që flet dhe që e thërret në emër. Feja është e lidhur me dëgjimin. Abrahami nuk e sheh Hyjin, por dëgjon zërin e tij. Në këtë mënyrë feja merr një karakter personal. Hyji shfaqet kështu jo si Hyji i një vendi dhe as si Hyji i lidhur me një kohë të she-nytë specifike, por si Hyji i një personi, domethënë si Hyji i Abrahamit, i Izakut dhe i Jakobit, i aftë të vihet në kontakt me njeriun dhe të bëjë me të një besëlidhje. Feja është përgjigjja ndaj një Fjale që thërret personalisht, ndaj një Ti-je që na thërret në emër.

9. Ajo që kjo Fjalë i thotë Abrahamit është një thirrje dhe një premtim. Është para së gjithash thirrje për të dalë prej tokës së tij, ftesë për t'iu hapur një jete të re, fillim i një daljeje që e çon drejt një të

⁷ Krh. p.sh. KONCILI I i VATIKANIT, Kushtetuta dogmatike mbi fenë katolike *Dei Filius*, kap. III: DS 3008-3020; KONCILI II i VATIKANIT, Kushtetuta dogmatike mbi Zbulimin hyjnor *Dei Verbum* (Fjala e Hyjit), 5; *Katekizmi i Kishës Katolike*, 153-165.

ardhmeje të papritur. Pamja që feja do t'i japë Abrahamit do të jetë gjithmonë e lidhur me këtë hap përpara që ai duhet të bëjë: feja "sheh" në atë masë me të cilën ai ecën, me të cilën ai hyn në hapësirën e Fjalës së Hyjit. Kjo Fjalë përmban gjithashtu një premtim: pasar-dhësia jote do të jetë e madhe, do të jesh ati i një populli të madh (krh. Zan 13,16; 15,5; 22,17). Është e vërtetë se, si përgjigje ndaj një Fjale që paraprin, feja e Abrahamit do të jetë gjithmonë një akt kujtimi. Megjithatë, ky kujtim nuk të lë të lidhur me të kaluarën por, duke qenë kujtimi i një premtimi, bëhet i aftë ta hapë njeriun ndaj të ardhmes, të ndriçojë hapat e tij gjatë rrugës. Kështu shihet se si feja, kujtim i së ardhmes, memoria futuri, është e lidhur ngushtë me shpresën.

10. Ajo që i kërkohet Abrahamit është që t'i besohet kësaj Fjale. Feja kupton se fjala, një realitet në dukje i përkohshëm dhe kalimtar, kur shqiptohet nga Hyji besnik bëhet gjëja më e sigurt dhe më e patundur që mund të ekzistojë, ajo që e bën të mundur vazhdimësinë e ecjes sonë në kohë. Feja e pranon këtë Fjalë si shkëmbin e sigurt mbi të cilin mund të hedhë themelet e veta të qëndrueshme. Prandaj në Bibël feja tregohet me fjalën hebraike 'emûnah, që rrjedh prej foljes 'amàn, që në rrënjën e vet do të thotë "mbështes". Termi 'emûnah mund të shprehë si besnikërinë e Hyjit, ashtu edhe fenë e njeriut. Njeriu besnik e merr forcën e vet prej të besuarit në duart e Hyjit besnik. Duke luajtur mbi dy domethëniet e fjalës - të pranishme edhe në termat përkatës në gjuhën greke (pistós) dhe latine (fidelis) -, shën Cirili i Jerusalemit do ta lartësojë di-njitetin e të krishterit, që merr vetë emrin e Hyjit: të dy quhen "besnikë".⁸ Shën Agustini do ta shpjegojë kështu: «Njeriu besnik është ai që i beson Hyjit që premtton; Hyji besnik është ai që i jep njeriut atë që i ka premtuar atij».⁹

11. Një aspekt i fundit i historisë së Abrahamit është i rëndësishëm për të kuptuar fenë e tij. Fjala e Hyjit, edhe pse bart me vete risi dhe befasi, nuk shfaqet aspak e huaj për përvojën e Patriarkut. Në zërin që i drejtohet Abrahamit, ky i fundit njeh një thirrje të thellë, të shkruar qysh prej amshimit në zemrën e tij. Hyji e lidh premtimin e vet me atë "vend" në të cilin ekzistenca e njeriut dëftohet gjithmonë premtuese: atësia, lindja e një jete të re - «Sara, gruaja jote, do të lindë djalë dhe ngjitja emrin Izak» (Zan 17,19). Ai Hyj që i kërkon Abrahamit t'i besohet tërësisht Atij zbulohet si burimi prej të cilit vjen çdo jetë. Në këtë mënyrë feja lidhet me Atësinë e Hyjit, prej së cilës buron krijimi: Hyji që thërret Abrahamin është Hyji krijues, Ai që «grish në jetë atë që nuk është» (Rom 4,17), Ai që «na zgjodhi para krijimit të botës... na parashënoi për vete të jemi bij në shpirt» (Ef 1,4-5). Për Abrahamin feja në Hyjin ndriçon rrënjët më të thella të qenies së tij, i lejon të njohë burimin e mirësisë që gjendet në zanafi-llën e të gjitha gjërave dhe të pohojë se jeta e tij nuk vjen prej asgjëse apo prej rastit, por prej një thirrjeje dhe një dashurie personale. Hyji i mistershëm që e ka thirrur nuk është një Hyj i huaj, por Ai që është në zanafillën e gjithçkaje dhe që mban gjithçka. Prova e madhe e fesë së Abrahamit, flijimi i të birit Izak, do të tregojë se deri në ç' pikë kjo dashuri zanafillore është e aftë ta garantojë jetën edhe përtej vdekjes. Fjala që është e aftë t'i japë jetë një biri në trupin e tij "pothuajse të vdekur" dhe "në kraharorin pothuajse të vdekur" të Sarës shterpë (krh. Rom 4,19), do të jetë e aftë

⁸. Krh. *Catechesis* V, 1: PG 33, 505A.

⁹. In *Psal.* 32, II, s. I, 9: PL 36, 284.

edhe të garantojë premtimin e një të ardhmeje përtej çdo kërcënimi apo rreziku (krh. Heb 11,19; Rom 4, 21).

Feja e Izraelit

12. Historia e popullit të Izraelit, në librin e Daljes, vijon në vazhden e fesë së Abrahamit. Feja lind përsëri prej një dhurate zanafillore: Izraeli i hapet veprimit të Hyjit, i cili dëshiron ta lirojë prej mjerrimit. Feja është thirrur të bëjë një ecje të gjatë derisa të arrijë ta adhurojë Zotin në Sinai dhe të trashëgojë një tokë të premtuar. Dashuria hyjnore ka karakteristikat e atit që mbart fëmijën e vet gjatë udhëtimit (krh. Lp 1,31). Dëshmimi i fesë së Izraelit zhvillohet si tregim i të mirave të Hyjit, i veprimit të tij për ta liruar dhe për ta udhëhequr popullin (krh. Lp 26,5-11), tregim që populli e përçon nga breznia në brezni. Drita e Hyjit shkëlqen për Izraelin nëpërmjet kujtimit të veprave të bëra prej Zotit, të kujtuara e të dëshmuara në kult, të përçuara nga prindërit te fëmijët. Mësojmë kështu se drita e sjellë prej fesë është e lidhur me tregimin konkret të jetës, me kujtimin mirënjohës të të mirave të Hyjit dhe me përmbushjen shkallë-shkallë të premtimeve të tij. Arkitektura gotike e ka shprehur këtë shumë mirë: në Katedralet e mëdha drita vjen prej qiellit nëpërmjet xhamtinës ku para-qitet historia e shenjtë. Drita e Hyjit na vjen nëpërmjet tregimit të zbulimit të tij dhe kështu është e aftë ta ndriçojë ecjen tonë në kohë, duke kujtuar të mirat hyjnore, duke treguar se si përmbushen premtimet e tij.

13. Historia e Izraelit na tregon përsëri tundimin e pabesimit në të cilin populli ka rënë shumë herë. E kundërta e fesë shfaqet këtu si idhujtari. Ndërsa Moisiu flet me Hyjin në Sinai, populli nuk e duron misterin e fytyrës së fshehur hyjnore, nuk e duron kohën e pritjes. Feja për natyrë të vet na kërkon që të heqim dorë prej zotërimit të menjëhershëm që pamja duket se jep, është një ftesë për t'u hapur ndaj burimit të dritës, duke respektuar misterin tipik të një Fytyre, që synon të zbulohet në mënyrë personale dhe në kohën e duhur. Martin Buber citonte këtë përkufizim të idhujtarisë të bërë prej rabinit të Kokut: kemi idhujtari «kur një fytyrë i drejtohet nderuese një fytyre që nuk është fytyrë».¹⁰ Në vend të fesë në Hyjin parapëlqehet të adhurohet idhulli, fytyra e të cilit mund të shikohet, zanafilla e të cilit është e njohur sepse është bërë prej nesh. Para idhullit nuk rrezikojmë mundësinë e një thirrjeje që na bën të dalim prej si-gurive tona, sepse idhujt «gojë kanë e nuk flasin» (Ps 115,5). Kështu kuptojmë se idhulli është një pretekst për ta vënë veten në qendër të realitetit, në adhurimin e veprës së duarve tona. Njeriu, pasi e humb orientimin themelor që i jep njësi ekzistencës së vet, humbet në dëshirat e veta të shumta; duke ia mohuar vetvetes që të presë kohën e premtimit, shpërbëhet në një mijë çastet e historisë së vet. Prandaj idhujtaria është gjithmonë politeizëm, lëvizje pa cak nga një zot te tjetri. Idhujtaria nuk ofron një ecje, por një shumicë shtigjesh, që nuk çojnë në një cak të sigurt, por paraqesin një labirint. Ai që nuk do t'i besohet Hyjit duhet të dë-gjojë zërat e idhujve të shumtë që i bërtasin: "M'u beso mua!". Feja, duke qenë e lidhur me kthimin, është e kundërta e idhujtarisë; është ndarje prej idhujve për t'u kthyer nga Hyji i gjallë, nëpërmjet një takimi personal. Të besosh do të thotë t'i besohesh një dashurie të mëshirshme që gjithmonë pranon e fal, që e mbështet dhe e orienton ekzistencën, që dëftohet e fuqishme në aftësinë e vet për t'i drejtuar shtrembërimet e

¹⁰. MARTIN BUBER, *Die Erzählungen der Chassidim*, Zyrih 1949, 793.

historisë sonë. Feja përbëhet në gatishmërinë që të lejojmë të shndërrohemi gjithnjë e përsëri prej thirrjes së Hyjit. Ja paradoksi: në të drejtuarin e vazhdueshëm kah Zoti, njeriu gjen një rrugë të qëndrueshme që e liron prej lëvizjes hallakatëse ndaj të cilës idhujt e nënshtrojnë atë.

14. Në fenë e Izraelit del në pah edhe figura e Moisiut, ndërmjetësit. Populli nuk mund ta shohë fytyrën e Hyjit; është Moisiu ai që flet me Jahven (YHWH) në mal dhe ua komunikon të gjithëve vullnesën e Zotit. Me këtë prani të ndërmjetësit, Izraeli ka mësuar të ecë i bashkuar. Akti i fesë së individit përfshihet në një bashkësi, në "ne"-në e përbashkët të popullit që, në fe, është si një njeri i vetëm, "i parëlinduri biri im", sikurse Hyji do ta quajë krejt Izraelin (krh. Dal 4,22). Ndërmjetësimi nuk bëhet këtu një pengesë, por një hapje: në takimin me të tjerët shikimi hapet drejt një të vërtete më të madhe se ne vetë. Zh. Zh. Ruso ankohej se nuk mund ta shihte Hyjin personalisht: «Sa njerëz ka mes Hyjit dhe meje!»;¹¹ «A është kaq e thjeshtë dhe natyrore që Hyji të ketë shkuar te Moisiu për t'i folur Zhan-Zhak Rusosë?».¹² Kuptimi i ndërmjetësimit nuk mund të arrihet duke nisur nga një konceptim individualist dhe i kufizuar i njohjes, kjo aftësi për të marrë pjesë në pamjen e tjetrit, dije e bashkëndarë që është dija tipike e dashurisë. Feja është një dhuratë falas e Hyjit që kërkon përvujtërinë dhe guximin për të zënë besë e për t'u besuar, për të parë ecjen e ndritshme të takimit mes Hyjit dhe njerëzve, historinë e shpëtimit.

Plotësia e fesë së krishterë

15. «Abrahami [...] galdoi në shpirt nga dëshira për ta parë ditën time. E pa dhe u gëzua» (Gjn 8,56). Sipas këtyre fjalëve të Jezusit, feja e Abrahamit ishte e orientuar drejt Tij, ishte, në njëfarë kuptimi, pamje e hershuar e misterit të tij. Kështu e kupton shën Agustini, kur pohon se Patriarkët u shpëtuan prej fesë, jo prej fesë në Krishtin e ardhur tashmë, por prej fesë në Krishtin që po vinte, fe e prirur drejt ngjarjes së ardhshme të Jezusit.¹³ Feja e krishterë është e përqendruar në Krishtin, është dëshmim se Jezusi është Zoti dhe se Hyji e ka ngjallur prej të vdekurve (krh. Rom 10,9). Të gjitha linjat e Besëlidhjes së Vjetër mblidhen në Krishtin, Ai bëhet "po"-ja përfundimtare ndaj të gjitha premtimeve, themeli i "Amen"-it tonë përfundimtar drejtuar Hyjit (krh. 2 Kor 1,20). Historia e Jezusit është shfaqja e plotë e besueshmërisë së Hyjit. Nëse Izraeli kujtonte punët e mëdha të dashurisë së Hyjit, që formonin qendrën e dëshmimit të tij dhe hapnin shikimin e fesë së tij, tani jeta e Jezusit duket si vendi i ndërhyrjes përfundimtare të Hyjit, dëftimi më i madh i dashurisë së tij për ne. Ajo që Hyji na drejton në Jezusin nuk është një fjalë më shumë mes shumë fjalëve të tjera, por Fjala e tij e amshuar (krh. Heb 1,1-2). Nuk ka asnjë garanci më të madhe që Hyji mund të japë për të na siguruar për dashurinë e vet, siç na kujton shën Pali (krh. Rom 8,31-39). Pra, feja e krishterë është fe në Dashurinë e plotë, në fuqinë e saj efikase, në aftësinë për ta shndërruar botën dhe për ta ndriçuar

¹¹. *Émile*, Paris 1966, 387.

¹². *Lettre à Christophe de Beaumont*, Luzanë 1993, 110.

¹³. Krh. *In Ioh. Evang.*, 45, 9: PL 35, 1722-1723.

kohën. «Ne e njohëm dashurinë që Hyji ka kundrejt nesh» (1 Gjn 4,16). Feja gjen në dashurinë e Hyjit të dëftuar në Jezusin themelin në të cilin mbështetet realiteti dhe qëllimi i tij i fundit.

16. Prova më e madhe e besueshmërisë së dashurisë së Krishtit gjendet në faktin se ka vdekur për njeriun. Nëse dhënia e jetës për miqtë është prova më e madhe e dashurisë (krh. Gjn 15,13), Jezusi ka dhënë jetën e vet për të gjithë, edhe për ata që ishin armiq, për ta shndërruar zemrën. Ja përse ungjilltarët e kanë vënë në orën e Kryqit momentin kulmor të shikimit të fesë, sepse në atë orë shkëlqen lartësia dhe gjerësia e dashurisë hyjnore. Shën Gjoni do ta vendosë këtu dëshminë e vet kremtore kur, së bashku me Nënë e Jezusit, soditi Atë që e kanë shporuar (krh. Gjn 19,37): «Dëshmon ai që pa, e dëshmia e tij është e vërtetë. Ai di se flet të vërtetën, që edhe ju të besoni» (Gjn 19,35). F. M. Dostojevski, në veprën e vet Idioti, në gojën e protagonistit, princit Myskin, që sheh pikturën e Krishtit të vdekur në varr, vepër e Hans Holbeinit të Riut, fjalët: «Ajo pikturë mund të bëjë edhe që ndonjëri ta humbë fenë».¹⁴ Në të vërtetë, piktura paraqet, në mënyrë shumë të fortë, efektet shkatërrimtare të vdekjes mbi trupin e Krishtit. E megjithatë, pikërisht në soditjen e vdekjes së Jezusit feja forcohet dhe merr një dritë shkëlqyese, kur ajo zbulohet si fe në dashurinë e patundur të tij për ne, që është e aftë të hyjë në vdekje për të na shpëtuar. Në këtë dashuri, që nuk i është shmangur vdekjes për të treguar se sa shumë më do, është e mundur të besoj; tërësia e saj mposht çdo dyshim dhe na lejon t'i besohemi plotësisht Krishtit.

17. Tani, vdekja e Krishtit zbulon besueshmërinë e plotë të dashurisë së Hyjit në dritën e Ngjalljes së tij. Si i ngjallur, Krishti është dëshmitar i besueshëm, i de-një për fe (krh. Zb 1,5; Heb 2,17), mbështetje e qëndrueshme për fenë tonë. «Në qoftë se Krishti nuk është ngjallur, e kotë është feja juaj», pohon shën Pali (1 Kor 15,17). Nëse dashuria e Atit nuk do ta kishte bërë Jezusin të ngjallej prej të vdekurve, nëse nuk do të kishte mundur t'i rrijepte jetë trupit të tij, atëherë nuk do të ishte një dashuri plotësisht e besueshme, e aftë të ndriçojë edhe errësirën e vdekjes. Kur shën Pali flet për jetën e vet të re në Krishtin, e ka fjalën për «fenë e Birit të Hyjit, i cili më deshi dhe e flijoi vetveten për mua» (Gal 2,20). Kjo “fe e Birit të Hyjit” është sigurisht feja e Apostullit të popujve në Jezusin, por supozon edhe besueshmërinë e Jezusit, që mbështetet jo vetëm në dashurinë e tij deri në vdekje, por edhe në të qenit e tij Bir i Hyjit. Pikërisht sepse Jezusi është Biri, meqë është i rrënjosur në mënyrë absolute në Atin, ka mundur ta mposhtë vdekjen dhe të bëjë që jeta të shkëlqejë në plotësi. Kultura jonë e ka humbur perceptimin e kësaj pranie konkrete të Hyjit, të veprimit të tij në botë. Mendojmë se Hyji gjendet vetëm përtej, në një tjetër nivel të realitetit, i ndarë prej marrëdhënieve tona njerëzore. Por po të ishte kështu, nëse Hyji do të ishte i paaftë të veprojë në botë, dashuria e tij nuk do të ishte me të vërtetë e fuqishme, me të vërtetë reale dhe prandaj nuk do të ishte as dashuri e vërtetë, e aftë ta japë atë lumturi që premtion. Të besojmë apo të mos besojmë në Të atëherë do të ishte krejtësisht e parëndësishme. Ndërsa të krishterët dëshmojnë dashurinë konkrete dhe të fuqishme të Hyjit, që vepron me të vërtetë në histori dhe përcakton fatin e saj përfundimtar, dashuri që është bërë e takueshme, që është zbuluar në plotësi në Mundimet, Vdekjen dhe Ngjalljen e Krishtit.

¹⁴. Pjesa II, IV.

18. Plotësia në të cilën Jezusi e çon fenë ka edhe një aspekt tjetër vendimtar. Në fe, Krishti nuk është vetëm Ai në të cilin besojmë, dëftimi më i lartë i dashurisë së Hyjit, por edhe Ai me të cilin bashkohemi që të mund të besojmë. Feja jo vetëm shikon Jezusin, por edhe shikon prej këndvështrimit të Jezusit, me sytë e tij: është një pjesëmarrje në mënyrën e tij të të shikuarit. Në shumë fusha të jetës u besohemi personave të tjerë që i njohin gjërat më mirë se ne. Kemi besim në arkitektin që ndërton shtëpinë tonë, në farmacistin që na jep ilaçin për shërim, në avokatin që na mbron në gjyq. Kemi nevojë edhe për dikë që është i besueshëm dhe ekspert në gjërat e Hyjit. Jezusi, Biri i tij, paraqitet si Ai që na shpjegon Hyjin (krh. Gjn 1,18). Jeta e Krishtit - mënyra se si ai e njeh Atin, se si ai jeton tërësisht në marrëdhënie me Të - hap një hapësirë të re për përvojën njerëzore dhe ne mund të hyjmë në të. Shën Gjoni e ka shprehur rëndësinë e marrëdhënies personale me Jezusin për fenë tonë nëpërmjet përdorimeve të ndryshme të foljes besoj. Së bashku me "besoj se" është e vërtetë ajo që Jezusi na thotë (krh. Gjn 14,10; 20,31), Gjoni përdor edhe shprehjet "i besoj" Jezusit dhe "besoj në" Jezusin. "I besojmë" Jezusit kur pranojmë Fjalën e tij, dëshminë e tij, sepse ai është i sigurtë (krh. Gjn 6,30). "Besojmë në" Jezusin kur e pranojmë personalisht në jetën tonë dhe i besohemi Atij, duke u bashkuar me Të në dashuri dhe duke e ndjekur përgjatë rrugës (krh. Gjn 2,11; 6,47; 12,44).

Me qëllim që të na japë mundësi ta njohim, ta pranojmë e ta ndjekim, Biri i Hyjit ka marrë trupin tonë, kështu ai e ka parë Atin edhe në mënyrë njerëzore, nëpërmjet një ecjeje dhe një rrugëtimi kohor. Feja e krishterë është fe në Mishërimin e Fjalës dhe në Ngjalljen e tij në trup; është fe në një Hyj që është bërë aq i afërt sa ka hyrë në historinë tonë. Feja në Birin e Hyjit të bërë njeri në Jezusin e Nazaretit nuk na ndan nga realiteti, por na lejon ta kuptojmë domethënien e tij më të thellë, të zbulojmë se sa shumë Hyji e do këtë botë dhe e orienton atë pareshtur drejt Vetes; një gjë e tillë e bën të krishterin të angazhohet, ta jetojë në mënyrë edhe më të gjallë ecjen në tokë.

Shpëtimi nëpërmjet fesë

19. Duke u nisur prej kësaj pjesëmarrjeje në mënyrën e shikimit të Jezusit, Pali apostull, në shkrimet e veta, na ka lënë një përshkrim të ekzistencës besimtare. Ai që beson, në pranimin e dhuratës së fesë, është i shndërruar në një krijesë të re, merr një qenie të re, një qenie birnore, bëhet bir në Birin. "Abbà, o Atë" është fjala më karakteristike e përvojës së Jezusit, që bëhet qendra e përvojës së krishterë (krh. Rom 8,15). Jeta në fe, si ekzistencë birnore, do të thotë ta njohim dhuratën zanafillore e rrënjësore që gjendet në bazën e ekzistencës së njeriut dhe mund të përmblihet në fjalinë e shën Palit drejtuar Korintianëve: «Çka ke që nuk e ke marrë?» (1 Kor 4,7). Pikërisht këtu gjendet zemra e polemikës së shën Palit me farisenjtë, diskutimi mbi shpëtimin nëpërmjet fesë apo nëpërmjet veprave të ligjit. Shën Pali nuk pranon qëndrimin e atij që dëshiron ta shfajësojë vetveten përpara Hyjit nëpërmjet veprës së vet. Ai, edhe kur u bindet urdhërimeve, edhe kur bën vepra të mira, vë në qendër vetveten dhe nuk pranon se zanafilla e mirësisë është Hyji. Ai që vepron kështu, ai që dëshiron të jetë burim i drejtësisë së vet, shpejt e sheh atë të shteruar dhe zbulon se as nuk mund t'i mbetet besnik ligjit. Mbyllet, duke

u izoluar prej Zotit dhe prej të tjerëve; kjo është arsyeja pse jeta e tij bëhet e kotë, veprat e tij të pafrytshme, si pema larg ujit. Shën Agustini kështu e shpreh me gjuhën e vet të përmbledhur dhe të efektshme: «Ab eo qui fecit te noli deficere nec ad te», «Prej atij që të ka bërë ty, mos u largo as për të shkuar drejt vetvetes».¹⁵ Kur njeriu mendon se duke u larguar prej Hyjit do të gjejë vetveten, ekzistenca e tij dështon (krh. Lk 15,11-24). Fillimi i shpëtimit është hapja ndaj diçkaje që paraprin, ndaj një dhurate fillestare që e pohon jetën dhe ruan në ekzistencë. Vetëm duke iu hapur kësaj zanafille dhe duke e njohur atë mund të shndërrohem, duke lejuar që shpëtimi të veprojë në ne dhe ta bëjë jetën tonë pjellore, plot me fryte të mira. Shpëtimi nëpërmjet fesë ka të bëjë me njohjen e parësisë së dhuratës së Hyjit, sikurse shpreh në mënyrë të përmbledhur shën Pali: «Me hir, në saje të fesë, jeni shëlbuar. Dhe kjo s'vjen prej jush, por është dhuratë e Hyjit» (Ef 2,8).

20. Logjika e re e fesë është e përqendruar në Krishtin. Feja në Krishtin na shpëton, sepse në Të jeta i hapet rrënjësisht një Dashurie që na paraprin dhe na shndërron nga brenda, që vepron në ne dhe me ne. Kjo duket qartë në egzegezën që Apostulli i popujve i bën një teksti të Ligjit të Përtërirë, egzegezë që përfshihet në dinamikën më të thellë të Besëlidhjes së Vjetër. Moisiu i thotë popullit se urdhri i Hyjit nuk është as tepër i lartë dhe as tepër larg njeriut. Nuk duhet të thuhet: «Kush mund të ngjitet për ne në qiell për të na e sjellë?» ose «Kush do të mund të kalojë përtej detit për ne për të na e sjellë?» (krh. Lp 30,11-14). Kjo afërsi e Fjalës së Hyjit interpretohet prej shën Palit siç referohet në praninë e Krishtit në të krishterin: «Mos thuaj në zemrën tënde: Kush do të ngrihet në qiell? - domethënë për të bërë që të zbresë Krishti -; as: Kush do të zbresë në Nëntokë? - domethënë për të bërë që Krishti të ngrihet prej të vdeku-rish» (Rom 10,6-7). Krishti ka zbritur në tokë dhe është ngjallur prej të vdekurish; me Mishërimin e tij dhe me Ngjalljen e tij, Biri i Hyjit ka përqafuar krejt ecjen e njeriut dhe banon në zemrat tona nëpërmjet Shpirtit Shenjt. Feja e di se Hyji është bërë shumë i afërt për ne, se Krishti na është dhënë si dhuratë e madhe që na shndërron përbrenda, që banon në ne, dhe kështu na dhuron dritën që ndriçon zanafillën dhe fundin e jetës, krejt harkun e ecjes njerëzore.

21. Kështu mund ta kuptojmë risinë në të cilën na çon feja. I krishteri është i shndërruar prej Dashurisë, së cilës i është hapur në fe, dhe duke iu hapur kësaj Dashurie që i është dhënë, ekzistenca e tij përhapet përtej vetes së tij. Shën Pali mund të pohojë: «jetoj, por jo më unë, në mua jeton Krishti» (Gal 2,20), dhe të nxisë: «që Krishti të banojë në zemrat tuaja» (Ef 3,17). Në fe, “un”-i i besimtarit zmadhohet për t’u banuar prej një Tjetri, për të jetuar në një Tjetër dhe kështu jeta e tij zgjerohet në Dashuri. Këtu vendoset veprimi tipik i Shpirtit Shenjt. I krishteri mund të ketë sytë e Jezusit, ndjenjat e tij, gjendjen e tij birnore, sepse bëhet pjesëmarrës i Dashurisë së tij, që është Shpirti. Pikërisht në këtë Dashuri merret në njëfarë mënyre pamja tipike e Jezusit. Jashtë kësaj marrjeje forme në Dashuri, jashtë pranisë së Shpirtit që ai e ndikon në zemrat tona (krh. Rom 5,5), është e pamundur ta dëshmojmë Jezusin si Zot (krh. 1 Kor 12,3).

Forma kishtare e fesë

¹⁵. De continentia, 4, 11: PL 40, 356.

22. Në këtë mënyrë ekzistenca besimtare bëhet ekzistencë kishtare. Kur shën Pali u flet të krishterëve të Romës për atë trup të vetëm që të gjithë besimtarët janë në Krishtin, i nxit që të mos mburren; në të vërtetë secili duhet ta çmojë veten «sipas masës së fesë që ia dhuroi Hyji» (Rom 12,3). Besimtari mëson ta shohë vetveten duke nisur prej fesë që dëshmon: figura e Krishtit është pasqyra në të cilin zbulon shëmbëlltyrën e vet të realizuar. Ashtu si Krishti i përqafton në vetvete të gjithë besimtarët, që formojnë trupin e tij, i krishteri e sheh veten të përfshirë në këtë trup, në marrëdhënien fillestare me Krishtin dhe me vëllezërit në fe. Shëmbëlltyra e trupit nuk dëshiron ta kthejë besimtarin thjesht në pjesë të një tërësie anonime, në element të një ingranazhi të madh, por thekson bashkimin jetësor të Krishtit me besimtarët dhe të të gjithë besimtarëve mes tyre (krh. Rom 12,4-5). Të krishterët janë “një” (krh. Gal 3,28), pa e humbur individualitetin e tyre, dhe secili prej tyre e fiton krejtësisht qenien e vet kur vihet në shërbim të të tjerëve. Kështu kuptohet përse jashtë këtij trupi, kësaj njësie të Kishës në Krishtin, kësaj Kishë që është - sipas fjalëve të Roman Guardinit - «bartësja historike e shikimit të plotë të Krishtit mbi botën»,¹⁶ feja e humb “masën” e vet, nuk e gjen më ekuilibrin e vet, hapësirën e ne-vojshme për t’u mbajtur. Feja ka një formë domosdoshmërisht kishtare, dëshmohet nga brendësia e trupit të Krishtit, si bashkësi konkrete e besimtarëve. Pikërisht prej këtij vendi kishtar ajo e hap secilin prej të krishterëve ndaj të gjithë njerëzve. Pasi i krishteri dëgjon Fjalën e Krishtit, falë edhe dinamizmit të vetë kësaj fjale, ajo shndërron në përgjigje dhe bëhet edhe vetë fjalë e shqiptuar, dëshmim i fesë. Shën Pali pohon: «Duhet të besosh në zemër [...], duhet ta dëshmosh fenë me gojë...» (Rom 10,10). Feja nuk është një fakt privat, një konceptim individualistik, një opinion subjektiv, por lind prej një dëgjimi dhe është e adresuar të shprehet dhe të bëhet predikim. Në të vërtetë, «E si do të besojnë në Atë, për të cilin nuk dëgjuan? Si do të dëgjojnë, nëse ndokush nuk ua predikon?» (Rom 10,14). Kështu feja bëhet vepruese në të krishterët duke filluar prej dhuratës së marrë, prej Dashurisë që na tërheq drejt Krishtit (krh. Gal 5,6) dhe na bën pjesëmarrës të ecjes së Kishës, shtegtare në histori drejt plotësisë. Për atë që është shndërruar në këtë mënyrë, hapet një mënyrë e re shikimi, feja bëhet dritë për sytë e tij.

KAPITULLI I DYTË

NËSE NUK DO TË BESONI,
NUK DO TË KUPTONI
(krh. Is 7,9)

Feja dhe e vërteta

23. Nëse nuk do të besoni, nuk do të kuptoni (krh. Is 7,9). Versioni grek i Biblës hebraike, përkthimi i të Shtatëdhjetëve realizuar në Aleksandrinë e Egjiptit, i për-kthente kështu fjalët e Isaisë profet drejtuar mbretit Akaz. Në këtë mënyrë çështja e njohjes së të vërtetës vihet në qendër të fesë. Megjithatë, në tekstin hebraik, lexojmë diçka tjetër. Në të profeti i thotë mbretit: “Nëse s’do të më

¹⁶. *Vom Wesen katholischer Weltanschauung* (1923), në: *Unterscheidung des Christlichen. Gesammelte Studien 1923-1963*, Mainz 1963, 24.

besoni, nuk do të mbeteni të qëndrueshëm". Këtu është një lojë fjalësh me dy forma të foljes 'amàn: "do të besoni" (ta'aminu), dhe "do të mbeteni të qëndrueshëm" (te'amenu). I frikësuar prej fuqisë së armiqve të vet, mbreti kërkon si-gurinë që mund t'ia japë një besëlidhje me perandorinë e madhe të Asirisë. Atëherë profeti e fton t'i besohet vetëm shkëmbit të vërtetë që nuk lëkundet, Hyjit të Izraelit. Meqenëse Hyji është i besueshëm, është gjë e arsyeshme të kesh fe në Të, ta ndërtosh sigurinë tënde mbi Fjalën e tij. Ky është Hyji që Isaia më tej do ta thërrasë, plot dy herë "Hyji Amen" (krh. Is 65,16), themel i patundur i besnikërisë ndaj besëlidhjes. Mund të mendohet se versioni grek i Biblës, duke përkthyer "të qenit i qëndrueshëm" me "të kuptuarit" ka bërë një ndryshim të thellë të tekstit, duke kaluar prej nocionit biblik të të besuarit Hyjit në atë grek të të kuptuarit. Megjithatë, ky përkthim, që e pranonte sigurisht dialogun me kulturën helenistike, nuk është i huaj për dinamikën e thellë të tekstit hebraik. Qëndrueshmëria që Isaia i premtton mbretit, në të vërtetë kalon nëpër të kuptuarit e veprimit të Hyjit dhe të njësisë që Ai i jep jetës së njeriut dhe historisë së popullit. Profeti nxit që të kuptohen udhët e Zotit, duke gjetur në besnikërinë e Hyjit planin e urtisë që drejton shekujt. Shën Agustini e ka shprehur përmbledhjen e "të kuptuarit" dhe të "të qenit i qëndrueshëm" në Rrëfimet e tij, kur flet për të vërtetën, së cilës njeriu mund t'ia besohet që të mund të mbetet në këmbë: «Do të jem i qëndrueshëm dhe do të forcohem në ty, [...] në të vërtetën tënde».¹⁷ Prej kontekstit e dimë se shën Agustini dëshiron të tregojë mënyrën në të cilën kjo e vërtetë e besueshme e Hyjit është, sikurse del në pah në Bibël, prania e tij besnike përgjatë historisë, aftësia e tij për t'ia mbajtur së bashku kohët, duke mbledhur hallakatjen e ditëve të njeriut.¹⁸

24. Teksti i Isaisë, i lexuar në këtë dritë, të çon në një përfundim: njeriu ka nevojë për njohjen, ka nevojë për të vërtetën, sepse pa të nuk mbahet, nuk ecën përpara. Feja, pa të vërtetën, nuk shpëton, nuk i bën të sigurt hapat tanë. Mbetet një përrallë e bukur, projektimi i dëshirave tona për lumturi, diçka që na kënaq vetëm në atë masë me të cilën dëshirojmë ta gënjëjmë vetveten. Ose kthehet në një ndjenjë të bukur, që ngushëllon dhe ngroh, por që ndryshon sa herë ndryshon humori ynë, sa herë ndryshojnë kohët, e paaftë ta mbajë një ecje të vazhdueshme në jetë. Nëse feja do të ishte kështu, mbreti Akaz do të kishte të drejtë që të mos e mbështeste jetën e vet dhe si-gurinë e vet në një emocion. Por pikërisht për lidhjen e saj të ngushtë me të vërtetën, feja është e aftë të japë një dritë të re, që është më lart se llogaritë e mbretit, sepse ajo sheh më larg, sepse e kupton të vepruarit e Hyjit, i cili është besnik ndaj besëli-dhjes së vet dhe ndaj premtimeve të veta.

25. Të kujtojmë lidhjen e fesë me të vërtetën sot është më e nevojshme se kurrë, pikërisht prej krizës së të vërtetës në të cilën jetojmë. Në kulturën bashkëkohore njerëzit shpesh janë të prirur ta pranojnë si të vërtetë vetëm atë të teknologjisë: është e vërtetë ajo që njeriu arrin të ndërtojë dhe të masë me dijen e vet, e vërtetë sepse funksionon dhe kështu e bën më të rehatshme dhe të lehtë jetën. Sot duket se kjo është e vetmja e vërtetë e sigurt, e vetmja që bashkëndahet me të tjerët, e vetmja mbi të cilën mund të diskutojmë dhe të angazhohemi së bashku. Nga ana tjetër do të ishin pastaj të vërtetat e

¹⁷. XI, 30, 40: PL 32, 825.

¹⁸. Krh. Po ai, 825-826.

individit, që përbëhen në të qenit të njëmendtë përpara asaj që secili ndien në brendësinë e vet, të vlefshme vetëm për individin dhe që nuk mund t'u propozohen të tjerëve me pretendimin se i shërbehet të mirës së përbashkët. E vërteta e madhe, e vërteta që shpjegon tërësinë e jetës personale e shoqërore, shikohet me dyshim. A nuk ka qenë kjo - pyesim veten - e vërteta e pretenduar prej totalitarizmave të mëdhenj të shekullit të kaluar, një e vërtetë që diktonte konceptimin e vet global për ta shtypur historinë konkrete të individit? Kështu mbetet vetëm një relativizëm në të cilin pyetja mbi të vërtetën e gjithçkaje, që në fund të fundit është edhe pyetja mbi Hyjin, nuk i intereson më askujt. Në këtë perspektivë, është logjike që të dëshirohet shkëputja e lidhjes së besimit me të vërtetën, sepse kjo lidhje do të ishte në rrënjë të fanatizmit, i cili kërkon ta mposhtë atë që nuk bashkëndon besimin e tij. Në lidhje me këtë, mund të flasim për një harresë të madhe në botën tonë bashkëkohore. Në të vërtetë, pyetja mbi të vërtetën është një çështje kujtimi, kujtimi të thellë, sepse i drejtohet diçkaje që na paraprin dhe, në këtë mënyrë, mund të arrijë të na bashkojë përtej "un"-it tonë të vogël dhe të kufizuar. Është një pyetje mbi zanafillën e gjithçkaje, në dritën e së cilës mund të shihet caku e kështu edhe kuptimi i rrugës së përbashkët.

Njohja e të vërtetës dhe dashuria

26. Në këtë situatë, a mundet feja t'i shërbejë të mirës së përbashkët në lidhje me mënyrën e duhur të të kuptuarit të së vërtetës? Për t'u përgjigjur është e nevojshme të reflektojmë mbi llojin e njohjes tipike të fesë. Mund të na ndihmojë një shprehje e shën Palit, kur pohon: «Duhet të besosh në zemër» (Rom 10,10). Zemra, në Bibël, është qendra e njeriut, ku gërshetohen të gjitha përmasat e saj: trupi dhe shpirti; brendësia e njeriut dhe hapja e tij ndaj botës e ndaj të tjerëve; intelekti, vullneti, afektiviteti. Kështu, nëse zemra është e aftë t'i mbajë së bashku këto përmasa, kjo ndodh sepse ajo është vendi ku i hapemi të vërtetës dhe dashurisë, si edhe lejojmë që ato të na prekin e të na shndërrojnë në thellësi. Feja e shndërron krejt personin, pikërisht sepse ky i fundit i hapet dashurisë. Në këtë gërshetim të fesë me dashurinë kuptohet forma e njohjes së fesë, forca e saj e bindjes, aftësia e saj për t'i ndriçuar hapat tanë. Feja njih, sepse është e lidhur me dashurinë, sepse vetë dashuria sjell një dritë. Të kuptuarit e fesë lind kur marrim dashurinë e madhe të Hyjit, që na shndërron përbrenda dhe na dhuron sy të rinj për të shikuar realitetin.

27. Është e njohur mënyra me të cilën filozofi Ludwig Wittgenstein e ka shpjeguar lidhjen mes fesë dhe sigurisë. Sipas tij, të besuarit është i ngjashëm me përvojën e të dashëruarit, e konceptuar si diçka subjektive, që nuk mund të propozohet si një e vërtetë e vlefshme për të gjithë.¹⁹ Në të vërtetë, njeriut modern i duket se çështja e dashurisë nuk ka të bëjë me të vërtetën. Sot dashuria është një përvojë e lidhur me botën e ndjenjave të paqëndrueshme dhe jo më me të vërtetën.

Përnjëmend, ky është një përshkrim i përshtatshëm i dashurisë? Në realitet, dashuria nuk mund të kufizohet në një ndjenjë që shkon e vjen. Është e vërtetë që ajo prek afektivitetin tonë, por për t'ia hapur atë personit të dashur dhe për të fi-lluar kështu një ecje, që është një dalje prej mbylljes në unin

¹⁹. Krh. *Vermischte Bemerkungen / Culture and Value*, G.H. von Wright (nën kujdesin e), Oksford 1991, 32-33; 61-64.

tonë dhe shkuarje drejt personit tjetër, për të ndërtuar një marrë-dhënie që zgjat; dashuria synon bashkimin me personin e dashur. Kështu zbulohet se në çfarë kuptimi dashuria ka nevojë për të vërtetën. Dashuria, vetëm duke qenë e mbështetur në të vërtetën mund të zgjasë në kohë, të kapërcejë çastin kalimtar dhe të mbetet e qëndrueshme për të përballuar një ecje të përbashkët. Nëse dashuria nuk ka marrëdhënie me të vërtetën, i nën-shtrohet ndryshimit të ndjenjave dhe nuk e kalon provën e kohës. Ndërsa dashuria e vërtetë i njëson të gjitha elementet tona dhe bëhet një dritë e re drejt një jete të madhe dhe të plotë. Pa të vërtetën dashuria nuk mund të japë një lidhje të fortë, nuk arrin ta çojë “un”-in përtej izolimit të tij, as ta lirojë atë prej çastit kalimtar për të ndërtuar jetën dhe për të sjellë fryt.

Nëse dashuria ka nevojë për të vërtetën, edhe e vërteta ka nevojë për dashurinë. Dashuria dhe e vërteta nuk mund të ndahen. Pa dashurinë, e vërteta bëhet e ftohtë, jo personale, shtypëse për jetën konkrete të personit. E vërteta që kërkojmë, ajo që u jep domethënie hapave tanë, na ndriçon kur jemi të prekur prej dashurisë. Ai që do, kupton se dashuria është përvoja e të vërtetës, se ajo vetë i hap sytë tanë për ta parë krejt realitetin në mënyrë të re, në bashkim me personin e dashur. Në këtë kuptim, shën Gregori i Madh ka shkruar se «amor ipse notitia est», vetë dashuria është një njohje, sjell me vete një logjikë të re.²⁰ Bëhet fjalë për një mënyrë marrë-dhënore të të shikuarit të botës, që bëhet njohje e bashkëndarë, pamje në pamjen e tjetrit dhe pamje e përbashkët mbi të gjitha gjërat. Guljelmi i Saint Thierry-së, në Mesjetë, ndjek këtë traditë kur komenton një rresht të Këngës së Këngëve në të cilën i dashuri i thotë së dashurës: Sytë e tu janë sy pëllumbeshe (krh. Kk 1,15).²¹ Këta dy sy, shpjegon Guljelmi, janë arsyeja besimtare dhe dashuria, që bëhen një sy i vetëm për të arritur të sodisin Hyjin, kur intelektin bëhet «intelekt i një dashurie të ndriçuar».²²

28. Ky zbulim i dashurisë si burim i njohjes, që i përket përvojës zanafillore të çdo njeriu, gjen një shprehje të autoritetshme në konceptin biblik të fesë. Duke shijuar dashurinë me të cilën Hyji e ka zgjedhur dhe e ka lindur si popull, Izraeli arrin të kuptojë njësinë e planit hyjnor, prej zanafillës deri në përmbushje. Njohja e fesë, për faktin se lind prej dashurisë së Hyjit që bën Besëli-dhje, është njohje që ndriçon një ecje në histori. Gjithashtu, pikërisht për këtë arsye në Bibël e vërteta dhe besnikëria shkojnë së bashku: Hyji i vërtetë është Hyji besnik, Ai që i mban premtimet e veta dhe, në kohë, lejon të kuptohet plani i tij. Nëpërmjet përvojës së profetëve, në dhimbjen e mërgimit dhe në shpresën e një kthimi përfundimtar në qytetin e shenjtë, Izraeli ka ndier se kjo e vërtetë e Hyjit shtrihej përtej historisë së tij, për të përqafuar krejt historinë e botës, duke filluar qysh prej krijimit. Njohja e fesë ndriçon jo vetëm rrugëtimin e posaçëm të një populli, por edhe krejt rrjedhën e botës së krijuar, që prej zanafillës së saj deri në konsumimin e saj.

Feja si dëgjim dhe pamje

²⁰. *Homiliae in Evangelia*, II, 27, 4: PL 76, 1207.

²¹. Krh. *Expositio super Cantica Cantorum*, XVIII, 88: CCL, *Continuatio Mediaevalis* 87, 67.

²². Po ai, XIX, 90: CCL, *Continuatio Mediaevalis* 87, 69.

29. Pikërisht sepse njohja e fesë është e lidhur me besëlidhjen e një Hyji besnik, që thur një marrëdhënie dashurie me njeriun dhe i drejton atij Fjalën, ajo paraqitet prej Biblës si një dëgjim dhe është lidhur me të dëgjuarit. Shën Pali do të përdorë një formulë që është bërë klasike: *fides ex auditu*, «besimi vjen nga predikimi» (Rom 10,17). Njohja e lidhur me fjalën është gjithmonë një njohje personale, që njih zërin, i hapet atij në liri dhe e ndjek në dëgjesë. Prandaj shën Pali ka folur për “dëgjesë të fesë” (krh. Rom 1,5; 16,26).²³ Gjithashtu, feja është njohje e lidhur me rrjedhjen e kohës, dhe fjala, që të shqiptohet, ka nevojë për këtë të fundit: është njohje që mësohet vetëm në një ecje ndjekjeje. Dëgjimi ndihmon që të paraqitet mirë lidhja mes njohjes dhe dashurisë.

Për sa i përket njohjes së të vërtetës, dëgjimi nganjëherë i është kundërvënë pamjes, që është tipike e kulturës greke. Nëse nga njëra anë drita jep soditjen e gjithçkaje, që njeriu gjithmonë ka dëshiruar, nga ana tjetër nuk duket se i lë hapësirë lirisë, sepse zbret prej qiellit dhe arrin drejtpërdrejt te syri, pa kërkuar që syri të përgjigjet. Gjithashtu, ajo duket se fton në një soditje statike, të ndarë prej kohës konkrete në të cilën njeriu gëzon dhe vuan. Sipas këtij koncepti, përçapja biblike e njohjes do t'i kundërvihet asaj greke, e cila, në kërkimin e një kuptimi të plotë të reales, e ka lidhur njohjen me pamjen.

Është e qartë se kjo kundërvënie e pretenduar nuk i përgjigjet së dhënës biblike. Besëlidhja e Vjetër i ka kombinuar të dyja llojet e njohjes, sepse me dëgjimin e Fjalës së Hyjit bashkohet dëshira për të parë fytyrën e tij. Në këtë mënyrë është arritur të zhvillohet një dialog me kulturën helenistike, dialog që i përket zemrës së Shkrimit. Dëgjimi vërteton thirrjen personale dhe dëgjesën, si edhe faktin se e vërteta zbulohet në kohë; shikimi jep pamjen e plotë të krejt rrugëtimit dhe mundëson të vihemi në planin e madh të Hyjit; pa këtë pamje do të kishim vetëm fragmente të shkëputura të një tërësie të panjohur.

30. Lidhja mes të shikuarit dhe të dëgjuarit, si organe të njohjes së fesë, vihet re me qartësinë më të madhe në Ungjillin e Gjonit. Për Ungjillin e katërt, të besosh do të thotë të dëgjosh dhe, në të njëjtën kohë, të shohësh. Dëgjimi i fesë ndodh sipas formës së njohjes së dashurisë: është një dëgjim personal, që e dallon zërin dhe e njih atë të Bariut të Mirë (krh. Gjn 10,3-5); një dëgjim që kërkon ndjekjen, siç ndodh me nxënësit e parë që, «dëgjuan ç' tha dhe u nisën pas Jezusit» (Gjn 1,37). Nga ana tjetër, feja është e lidhur edhe me pamjen. Nganjëherë, pamja e shenjave të Jezusit i paraprin fesë, sikurse me judenjtë që, pas ringjalljes së Lazrit, «kur panë çka bëri Jezusi, besuan në të» (Gjn 11,45). Herë të tjera, është feja ajo që çon në një pamje më të thellë: «Nëse do të besosh, do ta shohësh lavdinë e Hyjit» (Gjn 11,40). Në fund, të besuarit dhe të parit gërshetohen: «Kush beson në mua, nuk beson në mua, por në Atë që më dërgoi. Kush më sheh mua, sheh Atë që më dërgoi» (Gjn 12,44-45). Falë këtij bashkimi me dëgjimin, të parit bëhet ndjekje e Krishtit dhe feja duket si një ecje e shikimit, gjatë të cilës sytë

²³. «Hyjit i cili zbulon i detyrohem për “dëgjesën e fesë” (Rom 16,26; krh. Rom 1,5; 2 Kor 10,5-6), me të cilën njeriu braktiset në të krejtësisht dhe lirisht duke i dhënë nderimin e plotë të intelektit e të vullnetit dhe duke e pranuar vullnetarisht zbulimin që ai bën. Që të mund të jepet kjo fe, janë të nevojshëm hiri i Hyjit që paraprin dhe mbron dhe ndihmat e brendshme të Shpirtit Shenjt, i cili e lëviz zemrën dhe e drejton atë nga Hyji, i hap sytë e shpirtit dhe u jep të gjithëve ëmbëlsi në pranimin dhe në besimin e së vërtetës. Pastaj, që inteligjenca e Zbulimit të bëhet gjithnjë e më e thellë, vetë Shpirt Shenjt e përsos vazhdimisht fenë nëpërmjet dhuratave të veta» (KONCILII II i VATIKANIT, Kushtetuta dogmatike mbi Zbulimin hyjnor *Dei Verbum* [F j a l a e H y j i t] , 5) .

mësohen të shohin në thellësi. Kështu, mëngjesin e Pashkës, kalohet prej Gjonit që, ende në errësirë, para varrit të zbrazët, “pa e besoi” (Gjn 20,8) tek Maria Magdalenë që, tashmë, e sheh Jezusin (krh. Gjn 20,14) dhe dëshiron ta mbajë, por është e ftuar ta sodisë në ecjen e tij drejt Atit; deri në dëshmimin e plotë të vetë Magdalenës para nxënësve: «se e pa Zotërinë» (Gjn 20,18).

Si arrihet në këtë përmbledhje mes të dëgjuarit dhe të parit? Një gjë e tillë bëhet e mundur duke nisur prej personit konkret të Jezusit, i cili shihet dhe dëgjohej. Ai është Fjala e bërë njeri, lavdinë e të cilit e kemi soditur (krh. Gjn 1,14). Drita e fesë është ajo e një Fytyre në të cilën shihet Ati. Në fakt, e vërteta që feja arrin, në Ungji-llin e katërt është dëftimi i Atit në Birin, në trupin e tij dhe në veprat e tij tokësore, një e vërtetë që mund të përkufizohet si “jeta e ndritshme” e Jezusit.²⁴ Kjo do të thotë se njohja e fesë nuk na fton të shikojmë një të vërtetë thjesht të brendshme. E vërteta që feja na hap përpara është një e vërtetë e përqendruar në takimin me Krishtin, në soditjen e jetës së tij, në perceptimin e pranisë së tij. Në këtë kuptim, shën Toma i Akuitit flet për oculata fides të Apostujve - feja që sheh! - para pamjes trupore të të Ngjallurit.²⁵ E kanë parë Jezusin e ngjallur me sytë e tyre dhe kanë besuar, pra, kanë mundur të depërtojnë në thellësinë e asaj që shihnin për të dëshmuar Birin e Hyjit, të ulur në të djathtën e Atit.

31. Vetëm kështu, nëpërmjet Mishërimit, nëpërmjet bashkëndarjes së njerëzimit tonë, mund të arrinte në plotësi njohja e dashurisë. Në të vërtetë, drita e dashurisë lind kur prekemi në zemër, duke marrë kështu në veten tonë praninë e brendshme të personit të dashur, që na lejon ta pranojmë misterin e tij. Kështu kuptojmë se përse, së bashku me dëgjimin dhe shikimin, feja, për shën Gjonin, është një prekje, sikurse pohon në Letrën e tij të parë: «Çka dëgjuam, çka pamë me sytë tanë [...] dhe duart tona preken, në lidhje me Fjalën e jetës... » (1 Gjn 1,1). Me Mishërimitin e vet, me ardhjen e vet mes nesh, Jezusi na ka prekur dhe, nëpërmjet Sakramenteve, edhe sot na prek; në këtë mënyrë, duke e shndërruar zemrën tonë, na ka mundësuar dhe na mundëson ta njohim dhe ta dëshmojmë si Birin e Hyjit. Me anë të fenë, ne mund ta prekim dhe të marrim fuqinë e hirit të tij. Shën Agustini, duke komentuar pjesën e gruas që kishte derdhje gjaku, e cila prek Jezusin për t’u shëruar (krh. Lk 8,45-46), pohon: «Të prekësh me zemër, kjo do të thotë të besosh».²⁶ Turma shtyhet rreth tij, por nuk e arrin me preken personale të fesë, që e pranon misterin e tij, të qenit e tij Biri që dëfton Atin. Vetëm kur jemi të ngjashëm me Jezusin, marrim sy të përshtatshëm për ta parë atë.

Dialogu mes fesë dhe arsyes

32. Feja e krishterë, meqë shpall të vërtetën e dashurisë së plotë të Hyjit dhe të hap ndaj fuqisë së kësaj dashurie, arrin në qendrën më të thellë të përvojës së çdo nje-riu, që del në dritë falë dashurisë

²⁴. Krh. H. Schlier, *Meditationen über den Johanneischen Begriff der Wahrheit*, në: *Besinnung auf das Neue Testament. Exegetische Aufsätze und Vorträge* 2, Friburg, Bazel, Vjenë 1959, 272.

²⁵. Krh. S. Th. III, q. 55, a. 2, ad 1.

²⁶. *Sermo* 229/L, 2: PLS 2, 576: “*Tangere autem corde, hoc est credere*”.

dhe është i thirrur të dojë për të mbetur në dritë. Të nxitur prej dëshirës për të ndriçuar krejt realitetin, duke nisur prej dashurisë së Hyjit të dëftuar në Jezusin dhe duke kërkuar të duan me të njëjtën dashuri, të krishterët e parë gjetën në botën greke, në urinë e saj për të vërtetën, një partner të përshtatshëm për dialog. Takimi i mesazhit ungjillor me mendimin filozofik të botës së lashtë që një kalim vendimtar, pasi në këtë mënyrë Ungjilli mund të shkonte tek të gjithë popujt, si edhe favorizoi një ndërveprim të frytshëm mes fesë dhe arsyes, që shkoi duke u zhvilluar gjatë shekujve, deri në ditët tona. I lumi Gjon Pali II, në Letrën e vet enciklike Fides et ratio, ka treguar se si feja dhe arsyeja e forcojnë njëra-tjetrën.²⁷ Kur gjejmë dritën e plotë të dashurisë së Jezusit, zbulojmë se në çdo dashuri tonën ishte e pranishme një rreze e asaj drite dhe kuptojmë se cili ishte qëllimi i saj i fundit. Në të njëjtën kohë, fakti që dashuria jonë mbart me vete një dritë, na ndihmon të shohim ecjen e dashurisë drejt plotësisë së dhurimit total të Birit të Hyjit për ne. Në këtë lëvizje rrethore, drita e fesë i ndriçon të gjitha marrëdhëniet tona njerëzore, që mund të jetohen në bashkim me dashurinë dhe ëmbëlsinë e Krishtit.

33. Në jetën e shën Agustinit gjejmë një shembull domethënës të kësaj ecjeje ku kërkimi i arsyes, me dëshirën e vet për të vërtetën dhe qartësinë, është integruar në horizontin e fesë, nga ku ka marrë një kuptim të ri. Nga njëra anë, ai e pranon filozofinë greke të dritës me këmbënguljen e vet mbi pamjen. Takimi i tij me neoplatonizmin e ka bërë të njohë paradigmen e dritës, që zbrit nga lart për t'i ndriçuar gjërat dhe kështu është një simbol i Hyjit. Në këtë mënyrë shën Agustini e ka kuptuar transhendencën hyjnore dhe ka zbuluar se të gjitha gjërat kanë në vetvete një tejdukshmëri, pra, mund të pasqyronin mirësinë e Hyjit, të Mirën. Kështu është liruar prej manikeizmit në të cilin jetonte më parë dhe që e ndikonte të mendonte se e keqja dhe e mira luftonin vazhdimisht mes tyre, duke u ngatërruar dhe duke u përzier, pa kufij të qartë. Të kuptuarit se Hyji është dritë i ka dhënë një orientim të ri në ekzistencë, aftësinë për ta njohur të keqen për të cilën ishte fajtor dhe për t'u drejtuar kah e mira.

Nga ana tjetër, në përvojën konkrete të shën Agustinit, ai vetë në Rrëfimet e veta tregon se momenti vendimtar në ecjen e tij të fesë nuk ka qenë ai i një pamjeje të Hyjit, përtej kësaj bote, por ai i dëgjimit, kur në kopsht dëgjoji një zë që po i thoshte: "Merr e lexo!"; ai mori vëllimin me Letrat e shën Palit duke u ndalur në kapitullin e trembëdhjetë të letrës drejtuar Romakëve.²⁸ Shfaqej kështu Hyji personal i Biblës, i aftë që t'i flasë njeriut, të zbrësë për të jetuar me të dhe ta shoqërojë gjatë ecjes së tij në histori, duke u dëftuar në kohën e dëgjimit dhe të përgjigjes.

E megjithatë, ky takim me Hyjin e Fjalës nuk e bëri shën Agustinin të refuzonte dritën dhe pamjen. Ai i integroi të dyja perspektivat, i udhëhequr prej zbulimit të dashurisë së Hyjit në Jezusin. Në këtë mënyrë përpunoi një filozofi të dritës që përmban në vetvete ndërsjellshmërinë tipike të fjalës dhe i bën hapësirë lirisë së shikimit drejt dritës. Ashtu sikurse fjalës i korrespondon një përgjigje e lirë, po ashtu drita gjen si përgjigje një shëmbëlltyrë që e pasqyron. Shën Agustini mund t'i referohet kështu,

²⁷. Krh. Letra enciklike Fides et ratio (14 shtator 1998), 73: AAS (1999), 61-62.

²⁸. Krh. Confessiones, VIII, 12, 29: PL 32, 762.

duke bashkuar dëgjimin dhe pamjen, «fjalës që shkëlqen brenda njeriut».²⁹ Në këtë mënyrë drita bëhet, le të themi, drita e një fjale, sepse është drita e një Fytyre personale, një dritë që, duke na ndriçuar, na thërret dhe dëshiron të pasqyrohet në fytyrën tonë për të shkëlqyer prej brenda nesh. Nga ana tjetër, dëshira për pamjen e gjithçkaje, dhe jo vetëm të disa pjesëve të historisë, mbetet e pranishme dhe do të përmbushet në fund, kur njeriu, siç thotë Shenjti i Hiponës, do të shohë dhe do të dojë.³⁰ Dhe kjo, jo sepse do të jetë i aftë të zotërojë krejt dritën, që gjithmonë do të jetë e pashtershme, por sepse do të hyjë, i tëri, në dritë.

34. Drita e dashurisë, tipike e fesë, mund të ndriçojë pikëpyetjet e kohës sonë mbi të vërtetën. Sot e vërteta shpesh zvogëlohet deri në atë pikë sa paraqitet si një autenticitet subjektiv i individit, e vlefshme vetëm për jetën individuale. Një e vërtetë e përbashkët na shtie frikën, sepse e identifikojmë me diktimin e ngurtë të totalitarizmave. Por nëse e vërteta është e vërteta e dashurisë, nëse është e vërteta që hapet në takimin personal me Tjetrin dhe me të tjerët, atëherë mbetet e liruar prej mbylljes së individit dhe mund të bëjë pjesë në të mirën e përbashkët. Duke qenë e vërteta e një dashurie, nuk është e vërtetë që diktohet me dhunë, nuk është e vërtetë që e shtyp individin. Duke lindur prej dashurisë mund të arrijë në zemër, në qendrën personale të çdo njeriu. Kështu del qartë se feja nuk është e ngurtë, por rritet në bashkëjetesën që respekton tjetrin. Besimtari nuk është arrogant; përkundrazi, e vërteta e bën të përvuajtur, duke ditur se, më shumë se sa ta zotërojmë ne, është ajo që na përqafton dhe na zotëron ne. Pa na ngurtësuar, siguria e fesë na vë në ecje dhe bën të mundur dëshminë e dialogun me të gjithë.

Nga ana tjetër, drita e fesë, meqë është e bashkuar me të vërtetën e dashurisë, nuk është e huaj për botën materiale, sepse dashuria jetohe gjithmonë në trup e në shpirt; drita e fesë është dritë e mishëruar, që rrjedh prej jetës së ndritshme të Jezusit. Ajo ndriçon edhe lëndën, mbështetet në rendin e saj, pranon se në të hapet një ecje harmonie dhe kuptimi gjithnjë e më e ma-dhe. Kështu shikimi i shkencës përfiton prej fesë: kjo e fton shkencëtarin që të mbetet i hapur ndaj realitetit, në krejt pasurinë e tij të pashtershme. Feja zgjon ndjenjën kritike, meqë nuk i lejon kërkimit që të kënaqet me formulat e tij dhe e ndihmon të kuptojë se natyra është gjithmonë më e madhe. Duke ftuar për të provuar mahnitje përpara misterit të botës së krijuar, feja i zgjeron horizontet e arsyes për ta ndriçuar më mirë botën dhe u hapet studimeve të shkencës.

Feja dhe kërkimi i Hyjit

35. Drita e fesë në Jezusin ndriçon edhe ecjen e të gjithë atyre që e kërkojnë Hyjin dhe jep ndihmesën tipike të krishterimit në dialogun me ndjekësit e besimeve të ndryshme fetare. Letra drejtuar Hebrenjve na flet për dëshminë e të drejtëve që e kërkonin Hyjin me fe qysh përpara Besëlidhjes me Abrahamin. Për Henokun thuhet se «mori dëshminë se i kishte pëlqyer Hyjit» (Heb 11,5), gjë e pamundur pa fenë, sepse ai që «i afrohet [Hyjit] duhet të besojë se Hyji është [ekziston] dhe se i shpërblen ata që e

²⁹. De Trinitate, XV, 11, 20: PL 42, 1071: “verbum quod intus lucet”.

³⁰. Krh. De civitate Dei, XXII, 30, 5: PL 41, 804.

kërkojnë» (Heb 11,6). Kështu mund të kuptojmë se ecja e njeriut fetar kalon nëpër dëshmimin e një Hyji që kujdeset për të dhe që nuk është e pamundur të gjendet. Çfarë shpërblimi tjetër mund t'ju japë Hyji atyre që e kërkojnë, përveçse të mundësojë që ata ta takojnë atë? Edhe më parë, gjejmë figurën e Abelit, i cili lavdërohet për fenë për shkak të së cilës Hyjit i kanë pëlqyer dhuratat e tij, flia e të parëlindurve të grigjave të tij (krh. Heb 11,4). Njeriu fetar përpiket t'ju njohë shenjat e Hyjit në përvojat e përditshme të jetës së tij, në ciklin e stinëve, në frytshmërinë e tokës dhe në gjithë lëvizjen e kozmosit. Hyji është i ndritshëm dhe mund të gjendet edhe prej atyre që e kërkojnë me zemër të singertë.

Shëmbëlltyrë e këtij kërkimi janë Mbretërit e Lindjes, të udhëhequr prej yllit deri në Betlehem (krh. Mt 2,1-12). Për ta drita e Hyjit është shfaqur si ecje, si yll që udhëheq gjatë një rruge zbulimesh. Në këtë mënyrë ylli flet për durimin e Hyjit me sytë tanë, që duhet të mësohen me shkëlqimin e tij. Njeriu fetar është në ecje dhe duhet të jetë i gatshëm të lejojë të udhëhiqet, të dalë prej vetvetes për të gjetur Hyjin që befason gjithmonë. Ky respekt i Hyjit për sytë e njeriut na tregon se, kur njeriu i afrohet Atij, drita njerëzore nuk shpërbëhet në pafundësinë e ndritshme të Hyjit, sikur të ishte një yll i përpirë prej agimit, por bëhet më e ndritshme sa më afër zjarrit zanafillor të jetës, si pasqyra që pasqyron shkëlqimin. Dëshmimi i krishterë i Jezusit, shpëtimtarit të vetëm, pohon se krejt drita e Hyjit është përqendruar në Të, në "jetën e ndritshme" të tij, në të cilën zbulohet zanafilla dhe konsumimi i historisë.³¹ Nuk ka asnjë përvojë njerëzore, asnjë itinerar të njeriut drejt Hyjit, që të mos mund të pranohet, ndriçohet dhe pastrohet prej kësaj drite. Sa më shumë që i krishteri zhytet në rrethin e hapur prej dritës së Krishtit, aq më shumë është i aftë të kuptojë dhe të shoqërojë rrugën e çdo njeriu drejt Hyjit.

Meqenëse feja paraqitet si udhë, ajo i përket edhe jetës së njerëzve që, megjithëse duke mos besuar, dëshirojnë të besojnë dhe nuk reshtin së kërkuari. Në masën me të cilën i hapen dashurisë me zemër të singertë dhe vihen në ecje me atë dritë që arrijnë të kapin, qysh tani, pa e ditur, jetojnë në rrugën drejt fesë. Ata përpiqen të veprojnë sikur Hyji të ekzistonte, nganjëherë sepse e pranojnë rëndësinë e tij për të gjetur orientime të qëndrueshme në jetën e përbashkët, ose sepse përjetojnë dëshirën për dritë në mes të errësirës, por edhe sepse, duke perceptuar se sa e madhe dhe e bukur është jeta, ndiejnë se prania e Hyjit do ta bënte atë edhe më të madhe. Shën Ireneu i Lionit tregon se Abrahami, edhe para se ta dëgjonte zërin e Hyjit, e kërkonte atë «në dëshirën e zjarrtë të zemrës së tij», dhe «përshkonte gjithë botën, duke pyetur veten se ku ishte Hyji», derisa «Hyji pati mëshirë për të që, i vetëm, e kërkonte atë në heshtje».³² Ai që i hyn udhës për të praktikuar të mirën tashmë është duke iu afruar Hyjit, tashmë mbështetet prej ndihmës së tij, sepse është tipike e dinamikës së dritës hyjnore t'ju ndriçojë sytë tanë kur ecim drejt plotësisë së dashurisë.

Feja dhe teologjia

³¹. Krh. KONGREGATA PËR DOKTRINËN E FESË, *Deklarata Dominus Iesus* (6 gusht 2000), 15: AAS 92 (2000), 756.

³². *Demonstratio apostolicae praedicationis*, 24: SC 406, 117.

36. Meqenëse feja është një dritë, ajo na fton që të hyjmë në të, të eksplorojmë gjithnjë e më shumë horizontin që ndriçon, për ta njohur më mirë atë që duam. Prej kësaj dëshire lind teologjia e krishterë. Në këtë pikë është e qartë se teologjia është e pamundur pa fenë dhe se ajo i përket vetë lëvizjes së fesë, që kërkon inteligjencën më të thellë të vetëzbulimit të Hyjit, të kulmuar në Misterin e Krishtit. Rrjedhoja e parë është se në teologji nuk bëhet vetëm një përpjekje e arsyes për të vërejtur dhe për të njohur, sikurse në shkencat eksperimentale. Hyji nuk mund të kthehet në një objekt. Ai është Subjekt që bëhet i njohur dhe dëftohet në marrëdhënien ndërpersonale. Feja e drejtë e orienton arsyen që t'i hapet dritës që vjen prej Hyjit, në mënyrë që ajo, e udhëhequr prej dashurisë për të vërtetën, të mund ta njohë Hyjin në mënyrë më të thellë. Doktorët dhe teologët e mëdhenj mesjetarë kanë treguar se teologjia, si dije e fesë, është një pjesëmarrje në njohjen që Hyji ka për veten e vet. Kështu, teologjia nuk është vetëm një fjalë mbi Hyjin, por para së gjithash është një pranim dhe një kërkim i një inteligjence më të thellë të asaj fjale që Hyji na drejton, fjalë që Hyji e thotë mbi veten e vet, sepse është një dialog i amshuar bashkësie dhe e pranon njeriun brenda këtij dialogu.³³ Pra, bën pjesë në teologji përvujtëria që lejon "të preket" prej Hyjit, që pranon kufizimet e veta përballë Misterit dhe që shtyhet të zbulojë, me disiplinën e arsyes, pasuritë e pashqyrtueshme të këtij Misteri.

Pastaj teologjia bashkëndan formën kishtare të fesë; drita e saj është drita e subjektit besimtar që është Kisha. Kjo, nga njëra anë, do të thotë se teologjia është në shërbim të fesë së të krishterëve, vihet përvujtërisht të ruajë dhe të thellojë të besuarit e të gjithëve, sidomos të më të thjeshtëve. Gjithashtu, teologjia, duke qenë se jeton prej fesë, nuk duhet ta konsiderojë Magjisterin e Papës dhe të Ipushkviëve në bashkim me të si diçka të jashtme, një kufizim të lirisë së vet, por, përkundrazi, si njërin prej momenteve të veta të brendshme, themeluese, meqë Magjisteri siguron kontaktin me burimin zanafillor, pra, jep sigurinë se merret prej Fjalës së Krishtit në tërësinë e saj.

KAPITULLI I TRETË

PO JU SHPALLI ATO QË MORA (krh. 1 Kor 15,3)

Kisha, nëna e fesë sonë

37. Ai që i është hapur dashurisë së Hyjit, që e ka dëgjuar zërin e tij dhe që e ka marrë dritën e tij, nuk mund ta mbajë këtë dhuratë për veten e vet. Meqenëse feja është dëgjim dhe pamje, ajo përçohet edhe si fjalë dhe si dritë. Duke u folur Korintianëve, Pali apostull ka përdorur këto dy shëmbëlltyra. Nga njëra anë, ai thotë: «E pasi e kemi të njëjtin shpirt feje, siç është në Shkrimin e shenjtë: Besova, prandaj edhe fola, edhe ne besojmë, prandaj edhe flasim» (2 Kor 4,13). Fjala e marrë bëhet përgjigje, dëshmim dhe, në këtë mënyrë, jehon për të tjerët, duke i ftuar ata të besojnë. Nga ana tjetër, shën Pali i referohet edhe dritës: «Me fytyrë të zbuluar, bredhim lavdinë e Zotit, me anë të Shpirtit të Zotit, shndërrohemi në të njëjtën trajtë» (2 Kor 3,18). Është një dritë që pasqyrohet prej fytyrës në fytyrë,

³³. Krh. BONAVENTURA, *Breviloquium, prol.*: Opera Omnia, V, Quaracchi 1891, fq. 201; *In I Sent., proem*, q. 1, resp.: Opera Omnia, I, Quaracchi 1891, fq. 7; Toma i Akuinanit, S. Th. I, q. 1.

ashtu sikurse Moisiu mbante në vete pasqyrimin e lavdisë së Hyjit pasi kishte folur me Të: «[Hyji] ndriti në zemrat tona, që të shkëlqejë njohuria e lavdisë së Hyjit në fytyrën e Krishtit» (2 Kor 4,6). Drita e Jezusit ndriçon, si në një pasqyrë, në fytyrën e të krishterëve dhe kështu përhapet, kështu arrin deri te ne, që edhe ne të mund të marrim pjesë në këtë pamje dhe t'ua pasqyrojmë të tjerëve dritën e tij, sikurse në liturgjinë e Pashkës drita e qiriut ndez shumë qirinj të tjerë. Feja përçohet, le të themi kështu, me anë të kontaktit, nga personi në person, si një flakë që ndizet prej një flake tjetër. Të krishterët, në varfërinë e tyre, mbjellin një farë aq të frytshme saqë bëhet një pemë e madhe dhe është e aftë ta mbushë botën me fryte.

38. Përçimi i fesë, që shkëlqen për të gjithë njerëzit e të gjitha vendeve, kalon edhe nëpërmjet aksit të kohës, nga breznia në brezni. Meqenëse feja lind prej një takimi që ndodh në histori dhe ndriçon ecjen tonë në kohë, ajo duhet të përçohet përgjatë shekujve. Fytyra e Jezusit arrin deri te ne nëpërmjet një zinxhiri të pandërprerë dëshmish. Si është e mundur kjo? Si mund të jemi të sigurt se jemi në komunikim të drejtpërdrejtë me “Jezusin e vërtetë”, përgjatë shekujve? Nëse njeriu do të ishte një individ i izoluar, nëse do të donim të niseshim vetëm prej “un”-it individual, që dëshiron ta gjejë në vetvete sigurinë e njohjes së vet, kjo siguri do të ishte e pamundur. Unë nuk jam i zoti ta shoh atë që ka ndodhur në një epokë aq të largët prej meje. Megjithatë, kjo nuk është e vetmja mënyrë me të cilën njeriu njeh. Personi jeton gjithmonë në marrëdhënie. Vjen prej të tjerëve, u përket të tjerëve, jeta e tij bëhet më e madhe kur takohet me të tjerët. Edhe njohja e vetvetes, vetëdija për vetveten, është e llojit marrëdhënor dhe është e lidhur me të tjerë që na kanë paraprirë: në rend të parë prindërit tanë, që na kanë dhënë jetën dhe emrin. Vetë gjuhën, fjalët me të cilat e interpretojmë jetën tonë dhe realitetin tonë, e mësojmë nëpërmjet të tjerëve, që është ruajtur në kujtesën e gjallë të të tjerëve. Njohja e vetes sonë është e mundur vetëm kur marrim pjesë në një kujtim më të madh. Kështu ndodh edhe në fe, që e çon në plotësi mënyrën njerëzore të të kuptuarit. E kaluara e fesë, akt dashurie e Jezusit që ka krijuar në botë një jetë të re, vjen te ne përmes kujtimit të të tjerëve, të dëshmitarëve, që është ruajtur e gjallë në atë subjekt të vetëm të kujtimit që është Kisha. Kisha është një Nënë që na mëson të flasim gjuhën e fesë. Shën Gjoni ka këmbëngulur për këtë aspekt në Ungjillin e tij, duke bashkuar fenë dhe kujtimin, si edhe duke i lidhur të dyja me veprimin e Shpirtit Shenjt që, siç thotë Jezusi, «do t’ju përkujtojë gjithçka» (Gjn 14,26). Dashuria që është Shpirti dhe që banon në Kishë, i mban të bashkuara të gjitha kohët dhe na bën bashkëkohës të Jezusit, duke u bërë kështu udhërrëfyesi i ecjes sonë në fe.

39. Është e pamundur të besojmë vetëm. Feja nuk është vetëm një zgjedhje individuale që ndodh në brendësinë e besimtarit, nuk është marrëdhënie e izoluar mes “un”-it të besimtarit dhe “Ti”-së hyjnore, mes subjektit autonom dhe Hyjit. Ajo, për natyrë të vet, i hapet “ne”-së, ndodh gjithmonë brenda bashkësisë së Kishës. Forma e dialoguar e Besojmës, e përdorur në liturgjinë pagëzimore, na e kujton këtë gjë. Të besuarit shprehet si përgjigje ndaj një ftese, ndaj një fjale që duhet të dëgjohet dhe që nuk del prej meje, e prandaj përfshihet brenda një dialogu, nuk mund të jetë një dëshmim i thjeshtë që lind prej individit. Është e mundur të përgjigjemi në vetën e parë, “besoj”, vetëm sepse i përkasim një bashkësie të madhe, vetëm sepse thuhet edhe “besojmë”. Kjo hapje ndaj “ne”-së kishtarë ndodh sipas hapjes që është tipike e dashurisë së Hyjit, që nuk është vetëm marrëdhënie mes Atit e Birit, mes “un”-it dhe “ti”-së, por në Shpirtin Shenjt është edhe një “ne”, një bashkësi personash. Ja përse ai që beson nuk është kurrë vetëm dhe përse feja priret të përhapet, të ftojë edhe të tjerë në

gëzimin e vet. Ai që merr fenë zbulon se hapësirat e “un”-it të tij zgjerohen dhe në të lindin marrëdhënie të reja, që e pasurojnë jetën. Tertuliani e ka shprehur këtë me forcë kur flet për katekumenin, i cili “pas larjes së lindjes së re” pranohet në shtëpinë e Nënës për të shtrirë duart dhe për të lutur, së bashku me vëllezërit, lutjen Ati ynë, si i pranuar në një familje të re.³⁴

Sakramentet dhe përcimi i fesë

40. Kisha, si çdo familje, u përçon bijve të vet përmbajtjen e kujtimit të vet. Si mund ta bëjë këtë gjë, në mënyrë që asgjë të mos humbasë dhe që, përkundrazi, gjithçka të thellohet gjithnjë e më shumë në trashëgi-minë e fesë? Nëpërmjet Traditës Apostolike të ruajtur në Kishë me ndihmën e Shpirtit Shenjt, ne kemi një kontakt të gjallë me kujtimin themelues. Ajo që qe përçarur prej Apostujve - siç pohon Koncili II i Vatikanit - «përfshin gjithçka që ndihmon për jetën e shenjtë të popullit të Hyjit dhe për shtimin e fesë; kështu Kisha në doktrinën e vet, në jetën e vet dhe në kultin e vet, përjetëson dhe ua përçon të gjitha breznive gjithçka që ajo është, gjithçka që ajo beson».³⁵

Në të vërtetë, feja ka nevojë për një vend ku të dëshmohet e të komunikohet; ky vend duhet t'i përgjigjet e të jetë në përpjesëtim me atë që komunikohet. Për të përçarur një përmbajtje thjesht doktrinale, një ide, ndoshta do të mjaftonte një libër, ose përsëritja e një mesazhi gojor. Por ajo që komunikohet në Kishë, ajo që përçohet në Traditën e saj të gjallë, është drita e re që lind prej takimit me Hyjin e gjallë, një dritë që e prek personin në qendrën e tij, në zemër, duke përfshirë mendjen e tij, vullnetin e tij dhe afektivitetin e tij, duke e hapur atë ndaj marrëdhënieve të gjalla në bashkësi me Hyjin dhe me të tjerët. Për ta përçarur këtë plotësi ekziston një mjet i veçantë, që vë në lojë krejt personin, trup e shpirt, brendësi dhe marrëdhënie. Ky mjet janë Sakramentet, të kremtuara në liturgjinë e Kishës. Në ta komunikohet një kujtim i mishëruar, i lidhur me vendet dhe me kohët e jetës, i bashkuar me të gjitha shqisat; në ta personi është i përfshirë, si anëtar i një subjekti të gjallë, në një rrjet marrëdhëniesh bashkësiore. Prandaj, nëse është e vërtetë se Sakramentet janë Sakramentet e fesë,³⁶ duhet të themi edhe se feja ka një strukturë sakramentale. Rizgjimi i fesë kalon nëpër rizgimin e një ndjenje të re sakramentale të jetës së njeriut dhe të ekzistencës së krishterë, duke treguar se si e dukshmja dhe materialja i hapen misterit të të amshuarit.

41. Përcimi i fesë ndodh në radhë të parë me anë të Pagëzimit. Mund të duket se Pagëzimi është vetëm një mënyrë për të simbolizuar dëshmimin e fesë, një akt pedagogjik për atë që ka nevojë për shëmbëlltyra e gjeste, por i cili, në fund të fundit, mund të mos merret në konsideratë. Një fjalë e shën Palit, në lidhje me Pagëzimin, na kujton se nuk është kështu. Ai pohon se «me anë të pagëzimit, pra, bashkë me Të jemi varrosur në vdekje, që, sikurse Krishti u ngjall në lavdinë e Atit prej të vdekurve, po ashtu edhe ne të jetojmë në jetën e re» (Rom 6,4). Në Pagëzim bëhemi krijesë e re dhe bij të

³⁴. *Krh. De Baptismo*, 20, 5: CCL 1, 295.

³⁵. KONCILI II i VATIKANIT, Kushtetuta dogmatike mbi Zbulimin hyjnor *Dei Verbum* (Fjala e Hyjit), 8.

³⁶. *Krh. KONCILI II i VATIKANIT, Kushtetuta mbi Liturgjinë e shenjtë Sacrosanctum Concilium* (Koncili i Shenjtë), 59.

adoptuar të Hyjit. Apostulli pohon pastaj se i krishteri i është besuar një “forme mësimi” (typos didachés), së cilës i bindet zemra (krh. Rom 6,17). Në Pagëzim njeriu merr edhe një doktrinë që duhet ta dëshmojë dhe një formë konkrete jete, që kërkon përfshirjen e tij të plotë dhe që e drejton atë kah e mira. Zhvendoset në një vend të ri, i besohet një mjedisi të ri, një mënyre të re të të vepruarit të përbashkët, në Kishë. Në këtë mënyrë pagëzimi na kujton se feja nuk është vepër e individit të izoluar, nuk është një akt që njeriu mund ta kryejë duke u mbështetur vetëm në forcat e veta, por duhet të merret, duke hyrë në bashkësinë kishtare që përçon dhuratën e Hyjit: askush nuk e pagëzon veten e vet, ashtu sikurse askush nuk lind vetë në ekzistencë. Ne na kanë pagëzuar.

42. Cilat janë elementet pagëzimore që na fusin në këtë “formë mësimi” të re? Mbi katekumenin thirret në radhë të parë emri i Trinisë: Ati, Biri e Shpirti Shenjt. Kështu, qysh në fillim jepet një përmbledhje e ecjes së fesë. Hyji që ka thirrur Abrahamin dhe ka dashur të quhet Hyji i tij; Hyji që ia ka zbuluar emrin e vet Moisiut; Hyji që, duke na dorëzuar Birin e vet, na ka zbuluar plotësisht Emrin e tij, i dhuron të pagëzuarit një identitet të ri birnor. Në këtë mënyrë shfaqet kuptimi i veprimit që kryhet në Pagëzim, zhytja në ujë: uji, në të njëjtën kohë, është simbol i vdekjes, që na fton të kalojmë nëpër kthimin e “un”-it, për një hapje të tij ndaj një “Un”-i më të madh; por është edhe simbol i jetës, i kraharorit në të cilit rilindim duke ndjekur Krishtin në ekzistencën e tij të re. Në këtë mënyrë, nëpërmjet zhytjes në ujë, Pagëzimi na flet për strukturën e mishëruar të fesë. Veprimi i Krishtit na prek në realitetin tonë personal, duke na shndërruar rrënjësisht, duke na bërë bij adoptivë të Hyjit, pjesëmarrës të natyrës hyjnore; kështu modifikon të gjitha marrëdhëniet tona, situatën tonë konkrete në botë dhe në kozmos, duke i hapur ndaj vetë jetës së tij të bashkësisë. Ky dinamizëm shndërrimi tipik i Pagëzimit na ndihmon të dallojmë rëndësinë e katekumenatit, që sot, edhe në shoqëritë me rrënjë të hershme të krishtera, në të cilat një numër gjithnjë e më i madh të rriturish i afrohet sakramentit pagëzimor, merr një rëndësi të posaçme për ungjillëzimin e ri. Është rruga e përgatitjes për Pagëzim, për shndërrimin e krejt ekzistencës në Krishtin.

Për të kuptuar lidhjen mes Pagëzimit dhe fesë, mund të na ndihmojë teksti i Isaisë profet, që është lidhur me Pagëzimin në literaturën e lashtë të krishterë: «Strehimi i tij në qytezë të pathyeshme [...] ujët s’i mungon» (Is 33,16).³⁷ I pagëzuari, i shpërblyer prej ujit të vdekjes, mund të ngrihej në këmbë mbi “qytezën e pathyeshme”, sepse kishte gjetur atë qëndrueshmëri të cilës mund t’i besonte. Kështu, uji i vdekjes është shndërruar në ujë jete. Teksti grek e përshkruante si ujë pistós, ujë “besnik”. Uji i Pagëzimit është besnik, sepse atij mund t’i besohemi, sepse rryma e tij na fut në di-namikën e dashurisë së Jezusit, burimit të sigurisë për ecjen tonë në jetë.

43. Struktura e Pagëzimit, paraqitja e tij si rilindje, ku marrim një emër të ri dhe një jetë të re, na ndihmon të kuptojmë domethënien dhe rëndësinë e Pagëzimit të fëmijëve. Fëmija nuk është i aftë për një akt të lirë që të pranojë fenë, ende nuk mund ta dëshmojë atë vetë dhe pikërisht për këtë arsye ajo dëshmohet prej prindërve të tij dhe prej nënëve në emër të tij. Feja jetohet brenda bashkësisë së Kishës, është e për-fshirë në një “ne” të përbashkët. Kështu, fëmija mund të përkrahet prej të tjerëve,

³⁷. Krh. *Epistula Barnabae*, 11, 5: SC 172, 162.

prej prindërve dhe nunëve të tij, dhe mund të pranohet në fenë e tyre, që është feja e Kishës, e simbolizuar prej dritës që babai e merr prej qiriut në liturgjinë pagëzimore. Kjo strukturë e Pagëzimit vë në dukje rëndësinë e bashkëveprimit mes kishës dhe familjes në përcimin e fesë. Prindërit janë të thirrur, sipas një fjale të shën Agustinit, jo vetëm t'i lindin fëmijët në jetë, por edhe t'i çojnë drejt Hyjit në mënyrë që, me anë të Pagëzimit, të rilindin si bij të Hyjit, të marrin dhuratën e fesë.³⁸ Kështu, së bashku me jetën, atyre u jepet edhe orinetimi themelor i ekzistencës dhe siguria e një të ardhmeje të mirë, orientim që do të forcohet më tej në Sakramentin e Përforcimit me vulën e Shpirtit Shenjt.

44. Natyra sakramentale e fesë e gjen shprehjen e vet më të lartë në Eukaristi. Eukaristia është ushqimi i çmueshëm i fesë, takim me Krishtin e pranishëm në mënyrë reale me aktin suprem të dashurisë, dhurimin e Vetvetes që jep jetë.

Në Eukaristi gjejmë kryqëzimin e dy akseve mbi të cilat feja përshton ecjen e vet. Nga njëra anë, aksi i historisë: Eukaristia është akt kujtimi, aktualizim i misterit, në të cilin e kaluara, si ngjarje e vdekjes dhe e ngjalljes, tregon aftësinë e vet për të hapur ndaj së ardhmes, për të hershuar plotësinë përfundimtare. Liturgjia na e kujton këtë me hodie-n e vet, "të sotmen" e mistereve të shpëtimit. Nga ana tjetër, këtu gjendet edhe aksi që të çon prej botës së dukshme drejt së padukshmes. Në Eukaristi mësojmë të shohim thellësinë e reales. Buka dhe vera shndërrohen në trupin dhe gjakun e Krishtit, që bëhet i pranishëm në ecjen e tij pashkore drejt Atit: kjo lëvizje na fut, trup e shpirt, në lëvizjen e mbarë botës së krijuar drejt plotësisë së vet në Hyjin.

45. Në kremtimin e Sakramenteve, Kisha përçon kujtimin e vet, në veçanti, me dëshmimin e fesë. Në të, nuk bëhet fjalë edhe aq për t'i dhënë miratimin një tërësie të vërtetash abstrakte. Përkundrazi, në dëshmimin e fesë krejt jeta futet në një ecje drejt bashkësisë së plotë me Hyjin e gjallë. Mund të themi se në Besojmën besimtari ftohet që të futet në misterin që dëshmon dhe që ta lërë veten të shndërrohet prej asaj që dëshmon. Për ta kuptuar domethënien e këtij pohimi, le të mendojmë para së gjithash për përmbajtjen e Besojmës. Ajo ka një strukturë trinitare: Ati dhe Biri bashkohen në Shpirtin e dashurisë. Në këtë mënyrë besimtari pohon se qendra e qenies, sekreti më i thellë i të gjitha gjërave, është bashkësia hyjnore. Gjithashtu, Besojma përmban edhe një dëshmim kristologjik: ripërshtohen misteret e jetës së Jezusit, deri në Vdekjen, Ngjalljen dhe Të Ngjiturit në Qiell, në pritje të ardhjes së tij përfundimtare në lavdi. Pra, thuhet se ky Hyj bashkësi, shkëmbim dashurie mes Atit e Birit në Shpirtin, është i aftë ta përqafojë historinë e njeriut, ta fusë atë në dinamizmin e vet të bashkësisë, që ka në Atin zanafillën dhe cakun e vet përfundimtar. Ai që dëshmon fenë, e sheh veten të përfshirë në të vërtetën që dëshmon. Nuk mund t'i shqiptojë me të vërtetë fjalët e Besojmës, pa qenë i shndërruar prej saj, pa hyrë në historinë e dashurisë që e përqafon, që e zgjeron qenien e tij duke e bërë atë pjesë të një bashkësie të madhe, të subjektit të fundit që shqipton Besojmën dhe që është Kisha. Të gjitha të vërtetat që besohen shprehin misterin e jetës së re të fesë si ecje bashkësie me Hyjin e gjallë.

Feja, lutja dhe Dekalogu

³⁸. Krh. *De nuptiis et concupiscentia*, I, 4, 5: PL 44, 413: "*Habent quippe intentionem generandi regenerandos, ut qui ex eis saeculi filii nascuntur in D e i f i l i o s r e n a s c a n t u r*".

46. Dy elemente të tjera janë thelbësore për përcimin besnik të kujtimit të Kishës. Në radhë të parë, lutja e Zotit, Ati ynë. Në të i krishteri mëson të bashkëndajë të njëjtën përvojë shpirtërore të Krishtit dhe fillon të shikojë me sytë e Krishtit. Duke nisur nga Ai që është Dritë prej Dritës, nga Biri i Njëlindur i Atit, e njohim Hyjin edhe ne dhe mund të ndezim tek të tjerë dëshirën për t'iu afruar Atij.

Gjithashtu, është po aq e rëndësishme lidhja mes fesë dhe Dekalogut. Feja, siç thamë, shfaqet si një ecje, një rrugë që duhet përshkuar, e hapur ndaj takimit me Hyjin e gjallë. Prandaj, në dritën e fesë, të të besuarit të plotë në Hyjin që shpëton, Dekalogu fiton të vërtetën e vet më të thellë, që përmbahet në fjalët me të cilat fillojnë dhjetë urdhërimet: «Unë jam Zoti Hyji yt që të nxora nga dheu i Egjiptit» (Dal 20,2). Dekalogu nuk është një tërësi normash negative, por udhëzimesh konkrete për të dalë prej shkretëtirës së “un”-it që i referohet vetes së vet, të mbyllur në vetvete, dhe për të hyrë në dialog me Hyjin, duke e lënë veten që të përqafohemi prej zemërdhembshurisë së tij për të bartur zemërdhembshurinë e tij. Në këtë mënyrë feja dëshmon dashurinë e Hyjit, zanafillë dhe mbështetje e gjithçkaje, e lë veten të nxitet prej kësaj dashurie për të ecur drejt plotësisë së bashkësisë me Hyjin. Dekalogu shfaqet si ecje e mirënjohjes, e përgjigjes së dashurisë, e mundshme sepse, në fe, i jemi hapur përvojës së dashurisë shndërruese të Hyjit për ne. Kjo ecje merr një dritë të re prej asaj që Jezusi mëson në Fjalimin në Mal (krh. Mt 5-7).

Në këtë mënyrë ceka katër elementet që përmbledhin thesarin e kujtimit që Kisha përçon: Dëshmimin e fesë, kremtimin e Sakramenteve, ecjen e Dekalogut, lutjen. Katekeza e Kishës është strukturuar tradicionalisht përreth tyre, përfshirë edhe Katekizmi i Kishës Katolike, mjet themelor për atë akt njësues me të cilin Kisha komunikon përmbajtjen e plotë të fesë, «gjithçka që ajo është, gjithçka që ajo beson».³⁹

Njësia dhe tërësia e fesë

47. Njësia e Kishës, në kohë dhe në hapësirë, është e lidhur me njësinë e fesë: «një Trup të vetëm dhe një Shpirt të vetëm [...] një fe» (Ef 4, 4-5). Sot mund të duket i realizueshëm një bashkim i njerëzve në një angazhim të përbashkët, në dashurinë për njëri-tjetrin, në bashkëndarjen e të njëjtit fat, në një cak të përbashkët. Por e kemi shumë të vështirë të konceptojmë një njësi në të njëjtën të vërtetë. Na duket se një bashkim i tillë i kundërvihet lirisë së mendimit dhe autonomisë së subjektit. Ndërsa përvoja e dashurisë na thotë se pikërisht në dashuri është e mundur të kemi një pamje të përbashkët, se në të mësojmë ta shohim realitetin me sytë e tjetrit dhe se kjo nuk na varfëron, por e pasuron shikimin tonë. Dashuria e vërtetë, sipas masës së dashurisë hyjnore, kërkon të vërtetën dhe në shikimin e përbashkët të së vërtetës, që është Jezu Krishti, ajo bëhet e qëndrueshme dhe e thellë. Ky është edhe gëzimi i fesë, njësia e pamjes së një trupi të vetëm dhe të një shpirti të vetëm. Në këtë kuptim shën Luani i Madh mund të pohonte: «Nëse feja nuk është një, nuk është fe».⁴⁰

Cili është sekreti i kësaj njësie? Feja është “një”, në radhë të parë, prej njësisë së Hyjit të njohur dhe të dëshmuar. Të gjitha nenet e fesë i referohen Atij, janë rrugë për të njohur qenien e tij dhe të

³⁹. KONCILI II i VATIKANIT, Kushtetuta dogmatike mbi Zbulimin hyjnor *Dei Verbum* (Fjala e Hyjit), 8.

⁴⁰. *In nativitate Domini sermo* 4, 6: SC 22, 110.

vepruarin e tij, prandaj kanë një njësi më të lartë se çdo tjetër që mund të ndërtojmë me mendimin tonë, kanë njësinë që na pasuron, sepse na komunikohet ne dhe na bën “një”.

Gjithashtu, feja është një e vetme sepse i drejtohet të vetmit Zot, jetës së Jezusit, historisë së tij konkrete që bashkëndan me ne. Shën Ireneu i Lionit e ka sqaruar këtë në kundërvënien ndaj heretikëve gnostikë. Ata thoshin se ekzistonin dy lloje fesh, një fe e pagdhundur, feja e të thjeshtëve, e papërsosur, që mbetet në nivelin e trupit të Krishtit dhe të soditjes së mistereve të tij; dhe një lloj tjetër feje më e thellë dhe e përsosur, feja e vërtetë rezervuar një rrethi të vogël ndjekësish, që ngrihej me intelektin e vet përtej trupit të Jezusit drejt mistereve të hyjnisë së panjohur. Para këtij pretendimi, që vazhdon të ketë tërheqjen dhe ndjekësit e vet edhe në ditët tona, shën Ireneu thekson se feja është një e vetme, sepse kalon gjithmonë nëpër pikën konkrete të Mishërimit, pa e kapërcyer kurrë mishin dhe historinë e Krishtit, meqenëse Hyji ka dashur të zbulohet plotësisht në të. Pikërisht për këtë arsye nuk ka ndryshim në fe mes “atij që është në gjendje të flasë për të më gjatë” dhe “atij që flet pak për të”, mes atij që është më lart dhe atij që është më pak i aftë: i pari nuk mund ta zgjerojë fenë, as i dyti nuk mund ta zvogëlojë atë.⁴¹

Së fundi, feja është një e vetme sepse është e bashkëndarë nga mbarë Kisha, që është një trup i vetëm dhe një Shpirt i vetëm. Në bashkësinë e të vetmit subjekt që është Kisha, fitojmë një shikim të përbashkët. Duke dëshmuar të njëjtën fe mbështetemi në të njëjtin shkëmb, shndërrohemi prej të njëjtit Shpirt dashurie, rrezatojmë një dritë të vetme dhe kemi një shikim të vetëm për të depërtuar realitetin.

48. Meqenëse feja është një e vetme, duhet të dëshmohet në krejt pastërtinë dhe tërësinë e saj. Pikërisht sepse të gjitha nenet e fesë janë të lidhura në njësi, mohimi i njërit prej tyre, edhe i atyre që duken më pak të rëndësishëm, dëmton tërësinë. Çdo epokë mund të gjejë pika të fesë më të lehta apo më të vështira për t’u pranuar: prandaj është e rëndësishme të kemi kujdes që të përçohet krejt visari i fesë (krh. 1 Tim 6,20), të këmbëngulim siç duhet në të gjitha aspektet e dëshmimit të fesë. Në të vërtetë, meqenëse njësia e fesë është njësia e Kishës, t’i heqim diçka fesë do të thotë t’i heqim diçka të vërtetës së bashkësisë. Etërit e kanë përshkruar fenë si një trup, trupin e së vërtetës, me gjymtyrë të ndryshme, në analogji me trupin e Krishtit dhe me vazhdimin e këtij trupi që është Kisha.⁴² Tërësia e fesë është lidhur edhe me shëmbëlltyrën e Kishës virgjër, me besnikërinë e saj ndaj dashurisë martesore për Krishtin: të dëmtojmë fenë do të thotë të dëmtojmë bashkësinë me Zotin.⁴³ Pra, njësia e fesë është ajo e një organizmi të gjallë, siç e ka vënë mirë në dukje i lumi John Henry Newman kur radhiste, mes veçorive karakteristike për të dalluar vazhdimësinë e doktrinës në kohë, pushtetin e saj për të përvetësuar gjithçka që gjen, në vendet e ndryshme ku bëhet e pranishme, në kulturat e

⁴¹. Krh. IRENEU, *Adversus haereses*, I, 10, 2: SC 264, 160.

⁴². Krh. Po ai, II, 27, 1: SC 294, 264.

⁴³. Krh. AGUSTINI, *De sancta virginitate*, 48, 48: PL 40,424-425: “*Servatur et in fide inviolata quaedam castitas virginalis, qua Ecclesia uni viro virgo casta cooptatur*”.

ndryshme që takon,⁴⁴ duke pastruar dhe çuar gjithçka në shprehjen e vet më të mirë. Feja dëftohet kështu e gjithëmbarshtme, katolike, sepse drita e saj rritet për të ndriçuar krejt kozmosin dhe krejt historinë.

49. Si shërbim ndaj njësisë së fesë dhe ndaj përcimit të plotë të saj, Zoti i ka dhënë Kishës dhuratën e pasardhësisë apostolike. Nëpërmjet saj, garantohet vazhdimësia e kujtimit të Kishës dhe është e mundur të merret me siguri prej burimit të pastër nga i cili lind feja. Pra, garancia e lidhjes me zanafillën jepet prej personave të gjallë dhe kjo gjë i përgjigjet fesë së gjallë që Kisha përçon. Ajo mbështetet në besnikërinë e dëshmitarëve që janë zgjedhur prej Zotit për këtë detyrë. Prandaj Magjisteri flet gjithmonë në dëgjesë ndaj Fjalës zanafi-llore në të cilën mbështetet feja dhe është e besueshme sepse i besohet Fjalës që dë-gjon, ruan dhe paraqet.⁴⁵ Në fjalimin e lamtumirës drejtuar pleqve të Efesit, në Milet, të përmbledhur nga shën Luka në Veprat e Apostujve, shën Pali dëshmon se ka kryer detyrën që i është besuar prej Zotit që të kumtojë gjithçka «në lidhje me vullnetin [vullnesën] e Hyjit» (Vap 20,27). Falë Magjisterit të Kishës kjo vullnesë mund të na arrijë e plotë dhe së bashku me të edhe gëzimi se mund ta përmbushim atë në plotësi.

KAPITULLI I KATËRT

HYJI PËRGATIT PËR TA NJË QYTET

(krh. Heb 11,16)

Feja dhe e mira e përbashkët

50. Duke paraqitur historinë e Patriarkëve dhe të të drejtëve të Besëlidhjes së Vjetër, Letra drejtuar Hebrenjve vë në pah një aspekt thelbësor të fesë së tyre. Ajo nuk paraqitet vetëm si ecje, por edhe si ndërtimi dhe përgatitja e një vendi ku njeriu mund të banojë së bashku me të tjerët. Ndërtuesi i parë është Noehi që, në arkë, arrin të shpëtojë familjen e vet (krh. Heb 11,7). Pastaj shfaqet Abrahami, për të cilin thuhet se, me anë të fesë, banonte nën tenda, duke pritur qytetin me themele të palëkundshme (krh. Heb 11,9-10). Pra, në marrëdhënie me fenë, shfaqet një besueshmëri e re, një qëndrueshmëri e re, që vetëm Hyji mund ta dhurojë. Nëse njeriu i fesë mbështetet në Hyjin-Amen, në Hyjin besnik (krh. Is 65,16), dhe kështu bëhet edhe vetë i qëndrueshëm, mund të shtojmë se qëndrueshmëria e fesë i

⁴⁴. Krh. *An Essay on the Development of Christian Doctrine*, Uniform Edition: Longmans, Green and Company, Londër, 1868-1881, 185-189.

⁴⁵. Krh. KONCILI II i VATIKANIT, Kushtetuta dogmatike mbi Zbulimin hyjnor Dei Verbum (Fjala e Hyjit), 10.

referohet edhe qytetit që Hyji është duke përgatitur për njeriun. Feja zbulon se sa të forta mund të jenë lidhjet mes njerëzve, kur Hyji bëhet i pranishëm mes tyre. Nuk kujton vetëm një qëndrueshmëri të brendshme, një bindje të qëndrueshme të besimtarit; feja ndriçon edhe marrëdhëniet mes njerëzve, sepse lind prej dashurisë dhe ndjek dinamikën e dashurisë së Hyjit. Hyji i besueshëm u dhuron njerëzve një qytet të besueshëm.

51. Pikërisht falë lidhjes së saj me dashurinë (krh. Gal 5,6), drita e fesë vihet në shërbim konkret ndaj drejtësisë, ndaj së drejtës dhe ndaj paqes. Feja lind prej takimit me dashurinë zanafillore të Hyjit në të cilën shfaqet kuptimi dhe mirësia e jetës sonë; kjo ndriçohet në masën me të cilën hyn në dinamizmin e hapur prej kësaj dashurie, domethënë sa arrin të bëhet ecje dhe praktikë drejt plotësisë së dashurisë. Drita e fesë është në gjendje të vlerësojë pasurinë e marrëdhënieve njerëzore, aftësinë e tyre për të qenë të qëndrueshme, për të qenë të besueshme, për të pasuruar jetën e përbashkët. Feja nuk e largon njeriun prej botës dhe nuk është e shkëputur prej angazhimit konkret të bashkëkohësve tanë. Pa një dashuri të besueshme asgjë nuk do të mund t'i mbante me të vërtetë të bashkuar njerëzit. Njësia mes tyre do të konceptohej vetëm si e bazuar në dobinë, në interesat e përbashkëta, në frikën, por jo në mirësinë e të jetuarit së bashku, jo në gëzimin që edhe thjesht prania e tjetrit mund të ngjallë. Feja bën që të kuptohet arkitektura e marrëdhënieve njerëzore, sepse kupton themelin e fundit dhe fatin përfundimtar të tyre në Hyjin, në dashurinë e tij, dhe kështu ndriçon artin e ndërtimit, duke u bërë një shërbim për të mirën e përbashkët. Po, feja është një e mirë për të gjithë, është një e mirë e përbashkët, drita e saj nuk ndriçon vetëm brendësinë e Kishës, as nuk shërben vetëm për të ndërtuar një qytet të amshuar në botën e përtejme; ajo na ndihmon t'i ndërtojmë shoqëritë tona, në mënyrë që të ecin drejt një të ardhmeje shprese. Letra drejtuar Hebrenjve jep një shembull në lidhje me këtë gjë kur, mes njerëzve të fesë, përmend Samuelin dhe Davidin, të cilëve feja u mundësoi «të vinin në veprim drejtësinë» (krh. Heb 11,33). Kjo shprehje i referohet drejtësisë së tyre në qeverisje, asaj urtie që i sjell paqen popullit (krh. 1 Sam 12,3-5; 2 Sam 8,15). Duart e fesë ngrihen drejt qiellit, por e bëjnë këtë ndërsa ndërtojnë, në dashuri, një qytet të mbështetur në marrëdhëniet që kanë për themel dashurinë e Hyjit.

Feja dhe familja

52. Në ecjen e Abrahamit drejt qytetit të ardhshëm, Letra drejtuar Hebrenjve përmend bekimin që përçohet prej prindërve te bijtë (krh. Heb 11, 20-21). Vendi i parë ku feja ndriçon qytetin e njerëzve është familja. Mendoj para së gjithash për bashkimin e qëndrueshëm të burrit dhe të gruas në martesë. Ai lind prej dashurisë së tyre, shenjë dhe prani e dashurisë së Hyjit, prej njohjes dhe prej pranimi të mirësisë së ndryshimit gjinor, gjë prej të cilës bashkëshortët mund të bashkohen në një trup të vetëm (krh. Zan 2,24) dhe janë të aftë të lindin një jetë të re, shfaqje e mirësisë së Krijuesit, e urtisë së tij dhe e planit të tij të dashurisë. Të mbështetur në këtë dashuri, burri dhe gruaja mund t'i premtojnë njëri-tjetrit dashurinë e ndërsjellë me një gjest që përfshin krejt jetën dhe që kujton shumë karakteristika të fesë. Ne kemi mundësi të premtojmë një dashuri të përhershme kur zbulojmë një plan më të madh se planet tona, që na mbështet dhe na mundëson t'i dhurojmë krejt të ardhmen personit të dashur. Feja pastaj na ndihmon ta pra-nojmë në të gjithë thellësinë dhe pasurinë e vet

lindjen e fëmijëve, sepse na bën të shohim në të dashurinë krijuese që na dhuron dhe na beson misterin e një personi të ri. Pikërisht kështu Sara, me anë të fesë së vet, është bërë nënë, duke u mbështetur në besnikërinë e Hyjit ndaj premtimit të tij (krh. Heb 11,11).

53. Në familje, feja shoqëron të gjitha fazat e jetës, duke filluar prej fëmijërisë: fëmijët mësojnë t'i besojnë dashurisë së prindërve të tyre. Prandaj është e rëndësishme që prindërit të kultivojnë praktika të përbashkëta feje në familje, që të shoqë-rojnë pjekurimin e fesë së bijve të tyre. Sidomos të rinjtë, që përshkojnë një moshë të jetës kaq komplekse, të pasur dhe të rëndësishme për fenë, duhet të ndiejnë afërsinë e vëmendjen e familjes dhe të bashkësisë kishtarë në ecjen e tyre të rritjes në fe. Të gjithë kemi parë se si, në Ditët Botërore të Rinisë, të rinjtë shfaqin gëzimin e fesë, angazhimin për të jetuar një fe gjithnjë e më të qëndrueshme dhe bujare. Të rinjtë kanë dëshirë për një jetë të madhe. Takimi me Krishtin, faktin që e lënë veten të kapen dhe të udhëhiqen prej dashurisë së tij zgjeron horizontin e ekzistencës, i dhuron një shpresë të qëndrueshme që nuk zhgë-njen. Feja nuk është një strehë për njerëz pa guxim, por zgjerimi i jetës. Ajo na bën të zbulojmë një thirrje të madhe, thirrjen në dashuri, dhe na siguron se kjo dashuri është e besueshme, se ia vlen t'i dorëzohemi asaj, sepse themeli i saj gjendet në besnikërinë e Hyjit, që është më e fortë se çdo brishtësi e jona.

Një dritë për jetën në shoqëri

54. E përvetësuar dhe e thelluar në familje, feja bëhet dritë për t'i ndriçuar të gjitha marrëdhëniet shoqërore. Si përvojë e atësisë së Hyjit dhe e zemërdhembshurisë së Hyjit, shtrihet pastaj në ecje vëllazërore. "Moderniteti" ka bërë përpjekje për ta ndërtuar vëllazërinë universale mes njerëzve, duke u mbështetur në barazinë e tyre. Por, pak nga pak, kemi kuptuar se kjo vëllazëri, e privuar prej referimit në një Atë të përbashkët si themeli i saj i fundit, nuk arrin të ekzistojë. Pra, duhet të kthehemi në rrënjën e vërtetë të vëllazërisë. Historia e fesë, qysh prej fillimit të saj, ka qenë një histori vëllazërie, edhe pse jo pa konflikte. Hyji thërret Abrahamin për të dalë prej tokës së tij dhe i premtonte se do të bëjë prej tij një komb të vetëm të madh, një popull të madh, mbi të cilin pushon Bekimi hyjnor (krh. Zan 12,1-3). Në rrjedhën e historisë së shpëtimit, njeriu zbulon se Hyji dëshiron t'i bëjë të gjithë të marrin pjesë, si vëllezër, në të vetmin bekim, që e gjen plotësinë e vet në Jezusin, me qëllim që të gjithë të bëhen një. Dashuria e pashtershme e Atit na komunikohet, në Jezusin, edhe nëpërmjet pranisë së vëllait. Feja na mëson të shohim se në çdo njeri ka një bekim për mua, se drita e fytyrës së Hyjit më ndriçon nëpërmjet fytyrës së vëllait. Sa të mira i ka sjellë shikimi i fesë së krishterë qytetit të njerëzve për jetën e tyre të përbashkët! Falë fesë kemi kuptuar dinjitetin e vetëm të secilit person, që nuk ishte kaq i dukshëm në botën e lashtë. Në shekullin e dytë, Celsi pagan i qortonte të krishterët për atë që atij i dukej një iluzion dhe një mashtrim: mendimi se Hyji e kishte krijuar botën për njeriun, duke e vënë atë në kulmin e krejt kozmosit. Atëherë pyeste: «Pse të pretendojmë që [bari] të rritet për njerëzit dhe jo për kafshët më të egra pa arsye?»⁴⁶ «Po ta shohim tokën nga lartësia e qiellit, çfarë ndryshimi do të kishte mes veprimtarive tona dhe atyre të milingonave e të bletëve?»⁴⁷ Në qendër të

⁴⁶. ORIGJENI, *Contra Celsum*, IV, 75: SC 136, 372.

⁴⁷. Po ai, 85: SC 136, 394.

fesë biblike gjendet dashuria e Hyjit, kujdesi i tij konkret për çdo person, plani i tij i shpëtimit që përfaqon mbarë njerëzimin e krejt krijimin dhe që arrin kulmin në Mishërimin, Vdekjen e Ngjalljen e Jezu Krishtit. Kur ky realitet errësohet, mungon kriteri për të dalluar atë që e bën të çmueshme dhe të vetme jetën e njeriut. Ai e humb vendin e vet në gjithësi, ngatërrohet në natyrë, duke hequr dorë prej përgjegjësisë së vet morale, ose pretendon të jetë arbitër absolut, duke i dhënë vetes një pushtet manipulimi të pakufishëm.

55. Gjithashtu, feja, ndërsa na zbulon dashurinë e Hyjit Krijues, na bën ta respektojmë më shumë natyrën, duke na bërë të njohim në të një gramatikë të shkruar prej Tij dhe një banesë që na është besuar neve që ta kultivojmë e ta ruajmë; na ndihmon të gjejmë modele zhvillimi që nuk bazohen vetëm në dobinë dhe në përfitimin, por që konsiderojnë botën e krijuar si dhuratë, borxhlinj të së cilës jemi të gjithë; na mëson të gjejmë forma të drejta të qeverisjes, duke pranuar se autoriteti vjen prej Hyjit për të qenë në shërbim të së mirës së përbashkët. Feja pohon edhe mundësinë e faljes, që shumë herë ka nevojë për kohë, për mundim, për durim dhe për angazhim; falje e mundur nëse zbulohet se e mira është gjithmonë më zanafillore dhe më e fortë se e keqja, se fjala me të cilin Hyji pohon jetën tonë është më e thellë se të gjitha mohimet tona. Nga ana tjetër, edhe nga një këndvështrim thjesht antropologjik, njësia gjendet më lart se konflikti; duhet të marrim përsipër edhe konfliktin, por të jetuarit e tij duhet të na bëjë që ta zgjidhim atë, ta kapërcejmë, duke e shndërruar në hallkën e një zinxhiri, në një zhvillim drejt njësisë.

Kur feja mungon, ka rrezik që edhe themelet e jetës të mungojnë, sikurse paralajmëronte poeti T. S. Eliot: «Mos keni nevojë që t'ju thuhet se edhe ato suksese modeste / që ju mundësojnë të jeni krenarë për një shoqëri të edukuar / vështirë se do t'i mbijetojnë fesë së cilës i detyrohen për domethënien e tyre?».⁴⁸ Nëse e heqim fenë në Hyjin prej qyteteve tona, do të dobësohet besimi mes nesh, do të mbetemi të bashkuar vetëm prej frikës dhe stabiliteti do të kërcënohej. Letra drejtuar Hebrenjve pohon: «Hyjit nuk i vjen turp të quhet Hyji i tyre: vërtet, Ai ua ka bërë gati Qytetin» (Heb 11,16). Shprehja “nuk i vjen turp” lidhet me njohjen publike. Dëshirohet të thuhet se Hyji dëshmon publikisht, me veprimin e tij konkret, praninë e vet mes nesh, dëshirën e tij për t'i bërë të qëndrueshme marrëdhëniet mes njerëzve. Mos vallë do të turpërohemi ne ta quajmë Hyjin Hyji ynë? Mos vallë ne nuk do ta dëshmojmë si të tillë në jetën tonë publike, nuk do ta propozojmë madhështinë e jetës së përbashkët që Ai e bën të mundur? Feja ndriçon jetesën shoqërore; ajo ka një dritë krijuese për çdo moment të ri të historisë, sepse i vë të gjitha ngjarjet në marrëdhënie me zanafillën dhe fatin e gjithçkaje në Atin që na do.

Një forcë ngushëlluese në vuajtje

56. Shën Pali, duke u shkruar të krishterëve të Korintit për mundimet dhe vuajtjet e veta, vë në marrëdhënie fenë e vet me predikimin e Ungjillit. Në të vërtetë, ai thotë se në të përmbushet pjesa e Shkrimit: «Besova, prandaj edhe fola» (2 Kor 4,13). Apostulli i referohet një shprehjeje të Psalmi 116,

⁴⁸. “Choruses from *The Rock*” në: *The Collected Poems and Plays 1909-1950*, Nju Jork 1980, 106.

në të cilin Psalmisti brohoret: «Besoj edhe atëherë kur më duhet të them: Jam i pafat për së tepërmi» (rr. 10). Të flasësh për fenë shpesh të bën të flasësh edhe për provat e dhimbshme, por pikërisht në to shën Pali sheh predikimin më bindës të Ungji-llit, sepse pikërisht në dobësi dhe në vuajtje del në pah dhe zbulohet fuqia e Hyjit që e tejkalon dobësinë dhe vuajtjen tonë. Vetë apostulli gjendet në një situatë vdekjeje, që do të bëhet jetë për të krishterët (krh. 2 Kor 4,7-12). Në orën e provës, feja na ndriçon dhe pikërisht në vuajtje e në dobësi bëhet e qartë se si «ne nuk predikojmë vetveten, por Jezu Krishtin Zot» (2 Kor 4,5). Kapitulli 11 i Letrës drejtuar Hebrenjve përfundon duke përmenduar ata që kanë vuajtur për fenë (krh. Heb 11, 35-38), mes të cilëve një vend të veçantë zë Moisiu, i cili ka marrë mbi vete mundimin [poshtërimin] e Krishtit (krh. rr. 26). I krishteri e di se vuajtja nuk mund të zhduket, por mund të marrë një kuptim, mund të bëhet akt dashurie, besim në duart e Hyjit që nuk na braktis dhe, në këtë mënyrë, mund të jetë një etapë e rritjes së fesë dhe të dashurisë. Duke soditur bashkimin e Krishtit me Atin, edhe në momentin e vuajtjes më të madhe mbi kryq (krh. Mk 15,34), i krishteri mëson të marrë pjesë në vetë shikimin e Jezusit. Madje edhe vdekja del e ndriçuar dhe mund të jetohet si thirrja e fundit e fesë, e fundit “Dil prej vendit tënd” (Zan 12,1), e fundit “Eja!” e thënë prej Atit, të cilit i dorëzohemi me besimin se Ai do të na bëjë të qëndrueshëm edhe në hapin përfundimtar.

57. Drita e fesë nuk na bën t’i harrojmë vuajtjet e botës. Për sa burra e gra fetarë të vuajturit kanë qenë ndërmjetës drite! Për shembull për shën Françeskun e Asizit i gërbuluri apo për të Lumen Nënë Terezë të Kalkutës të varfrit e saj. Ata e kanë kuptuar misterin që gjendet në ta. Duke iu afruar atyre me siguri që nuk ua kanë zhdukur të gjitha vuajtjet e tyre, as nuk kanë mundur ta shpjegojnë të keqen. Feja nuk është dritë që davarit të gjitha errësirat, por dritëz që udhëheq natën hapat tanë dhe kjo mjafton për ecjen. Njeriut që vuan, Hyji nuk i dhuron një arsytim që shpjegon gjithçka, por i jep përgjigjen e tij në formën e një pranije që shoqëron, të një historie të së mirës që bashkohet me çdo histori vuajtjeje për të hapur në të një shteg drite. Në Krishtin, vetë Hyji ka dashur ta bashkëndajë me ne këtë rrugë dhe të na japë shikimin e vet për të parë në të dritën. Krishti është ai që, pasi e ka duruar dhimbjen, është «Autori dhe Përkryesi i fesë» (Heb 12,2).

Vuajtja na kujton se shërbimi i fesë ndaj të mirës së përbashkët është gjithmonë shërbim shprese, që shikon përpara, duke e ditur se vetëm prej Hyjit, prej të ardhmes që vjen prej Jezusit të ngjallur, mund të gjejë themele të qëndrueshme e të përhershme shoqëria jonë. Në këtë kuptim, feja është e lidhur me shpresën, sepse, edhe nëse banesa jonë këtu në tokë është duke u shkatërruar, ka një banesë të amshuar që Hyji e ka përruar tashmë në Krishtin, në trupin e tij (krh. 2 Kor 4,16-5,5). Në këtë mënyrë, dinamizmi i fesë, i shpresës dhe i dashurisë (krh. 1 Sel 1,3; 1 Kor 13,13) na bën të përqafojmë shqetësimet e të gjithë njerëzve, në ecjen tonë drejt atij qyteti, «arkitekti dhe ndërtuesi i të cilit është Hyji» (Heb 11,10), sepse «shpresa nuk turpëron» (Rom 5,5).

Në bashkim me fenë dhe dashurinë, shpresa na projekton drejt së ardhmes së sigurt, që vendoset në një perspektivë të ndryshme në krahasim me propozimet mashtruese të idhujve të botës, por që i dhuron një hov të ri dhe një forcë të re jetës së përditshme. Të mos lejojmë që të na vidhet shpresa, të mos lejojmë që ajo të asgjësohet me zgjidhje dhe propozime të menjëhershme që na pengojnë të ecim, që “e fragmentojnë” kohën, duke e shndërruar atë në një hapësirë. Koha është gjithmonë më lart se

hapësira. Hapësira kristalizon proceset, ndërsa koha projekton drejt së ardhmes dhe nxit për të ecur me shpresë.

E lumja ti që besove (Lk 1,45)

58. Në shëmbëlltyrën e mbjellësit, shën Luka sjell këto fjalë me të cilat Jezusi shpjegon domethënien e “tokës së mirë”: «janë ata që e dëgjojnë Fjalën dhe e ruajnë në zemër të mirë e bujare dhe japin fryt me qëndrueshmëri» (Lk 8,15). Në kontekstin e Ungjillit të Lukës, përmendja e zemrës së mirë dhe bujare, duke iu referuar Fjalës së dëgjuar dhe të ruajtur, përbën një portret të heshtur të fesë së Virgjërës Mari. Po ky ungjilltar na flet për kujtimin e Marisë, se si ajo ruante në zemrën e vet gjithçka që dëgjonte dhe shihte, në mënyrë që Fjala të sillte fryt në jetën e saj. Nëna e Zotit është ikona e përsosur e fesë, siç do të thotë she-ntja Elizabetë: «E lumja ti që besove» (Lk 1,45).

Në Marinë, Bijën e Sionit, përmbushet historia e gjatë e fesë e Besëlidhjes së Vjetër, me tregimin e shumë grave besnike, duke filluar nga Sara, gra që, krahas Patriarkëve, ishin vendi ku premtimi i Hyjit përmbushej dhe lindte jeta e re. Në plotësinë e kohëve Fjala e Hyjit i është drejtuar Marisë dhe ajo e ka pranuar me tërë qenien e vet, në zemrën e vet, në mënyrë që aty të merrte trup dhe të lindte si dritë për njerëzit. Shën Justini Martir, në veprën e vet Dialog me Trifonin, ka një shprehje të bukur në të cilën thotë se Maria, duke pranuar lajmin e Engjëllit, ka ngjizur “fe dhe gëzim”.⁴⁹ Në të vërtetë, feja është dëftuar e frytshme në Nënë e Jezusit dhe kur jeta jonë shpirtërore jep fryt, mbushemi me gëzim, që është shenja më e qartë e madhështisë së fesë. Në jetën e vet, Maria ka bërë shtegtimin e fesë në ndjekje të Birit të vet.⁵⁰ Kështu, në Marinë, ecja e fesë e Besëlidhjes së Vjetër përfshihet në ndjekjen e Jezusit dhe e lë veten të shndërronhet prej Tij, duke hyrë në shikimin tipik të Birit të Hyjit të mishëruar.

59. Mund të themi se në të Lumen Virgjërën Mari ndodh ajo për të cilën kam këmbëngulur më parë, domethënë se besimtari është i përfshirë tërësisht në dëshmimin e vet të fesë. Maria është e lidhur ngushtë, për shkak të lidhjen e vet me Jezusin, me atë që besojmë. Në të zënët virgjëror të Marisë kemi një shenjë të qartë të prejardhjes hyjnore të Krishtit. Zanafilla e amshuar e Krishtit është në Atin, Ai është Biri në kuptimin e tërësishëm dhe të vetëm; për këtë arsye lind në kohë pa ndërhyrje njerëzore. Duke qenë Bir, Jezusi mund të sjellë në botë një fillim të ri dhe një dritë të re, plotësinë e dashurisë besnike të Hyjit që u dorëzohet njerëzve. Nga ana tjetër, amësia e vërtetë e Marisë ka siguruar për Birin e Hyjit një histori të vërtetë njerëzore, një mish të vërtetë në të cilin do të vdesë në kryq dhe do të ngjallet prej të vdekurish. Maria do ta shoqërojë deri në kryq (krh. Gjn 19,25), nga ku amësia e saj do t’i shtrihet çdo nxënësi të Birit të saj (krh. Gjn 19,26-27). Do të jetë e pranishme edhe në çenakull, pas Ngjalljes dhe Të Ngjiturit në Qiell të Jezusit, për të kërkuar së bashku me Apostujt dhuratën e Shpirtit Shenjt (krh. Vap 1,14). Lëvizja e dashurisë mes Atit dhe Birit në Shpirtin ka përshkuar historinë tonë; Krishti na tërheq kah Vetja, me qëllim që të na shpëtojë (krh. Gjn 12,32). Në

⁴⁹. Krh. *Dialogus cum Tryphone Iudaeo*, 100, 5: PG 6, 710.

⁵⁰. Krh. KONCILI II i VATIKANIT, Kushtetuta dogmatike mbi Kishën *Lumen Gentium* (Drita e Popujve), 58.

qendër të fesë gjendet dëshmimi i Jezusit, Birit të Hyjit, të lindur prej gruaje, që na përfshin, me dhuratën e Shpirtit Shenjt, në bijësinë në shpirt (krh. Gal 4,4-6).

60. Marisë, nënës së Kishës dhe nënës së fesë sonë, le t'i drejtohem në lutje.

Ndihmoje, o Nënë, fenë tonë!

Hape dëgjimin tonë ndaj Fjalës, që ta njohim zërin e Hyjit dhe thirrjen e tij.

Zgjo në ne dëshirën që t'i ndjekim hapat e tij, duke dalë prej tokës sonë dhe duke pranuar premtimin e tij.

Na ndihmo që la lëmë veten të prekemi prej dashurisë së tij, që të mund ta prekim me anë të fesë.

Na ndihmo t'i besohemi plotësisht Atij, të besojmë në dashurinë e tij, sidomos në momentet e vuajtjes dhe të kryqit, kur feja jonë është e thirrur të piqet.

Mbill në fenë tonë gëzimin e të Ngjallurit.

Na kujto se ai që beson nuk është kurrë vetëm.

Na mëso të shikojmë me sytë e Jezusit, me qëllim që Ai të jetë dritë mbi ecjen tonë. Dhe që kjo dritë e fesë të rritet gjithmonë në ne, derisa të vijë ajo ditë pa perëndim, që është vetë Krishti, Biri yt, Zoti ynë!

Dhënë në Romë, pranë Shën Pjetrit, më 29 qershor, e krentja e Apostujve të Shenjtë Pjetrit e Palit, të vitit 2013, i pari i Pontifikatit.

FRANCISCUS

PËRBAJTJA

Partaqitja.....fq. 5

LUMEN FIDEI (DRITA E FESË).....13

KAPITULLI I PARË

I besuam dashurisë.....13

KAPITULLI I DYTË

Nëse nuk do të besoni,

nuk do të kuptoni.....47

KAPITULLI I TRETË

Po ju shpalli ato që mora.....77

KAPITULLI I KATËRT

Hyji përgatit për ta një qytet.....101

PËRBAJTJA.....121